

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XXII i botimit, nr. 243, Janar 2024

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër, Tel. +355685000229, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Klodjana Serraj, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

Realizimet e vitit 2023 - bazament i rëndësishëm për realizimin e misionit të SHAD dhe programi për vitin 2024 -

Të nderuar anëtare e anëtarë të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini"!

Të nderuar miq të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini"!

Të nderuar dukagjinas kudo ndodheni!

Në emër të Kryesisë së SHAD, ju informojmë mbi realizimin e programit për vitin 2023 dhe mbi programin e shoqatës për vitin 2024.

*Detyra kryesore e Kryesisë ka qene vijimi i botimit të gazetës "Dukagjini".

Gazeta "Dukagjini", në XXI vjetorin e botimit të saj mbërriti në botimin e 242 numrave, që do të thotë, në 242 muaj nuk është ndalur asnjëherë në saj të punës së palodhur e mjaft të përgjegjshme të Redaksisë së gazetës dhe bashkëpunëtorëve të saj. Janë afruar te gazeta "Dukagjini" 625 autore me nga një artikull dhe deri me 262 artikuj nga publicisti Prele Milani. Gjithsej 3 530 artikuj të ndryshëm sipas objekteve kryesore: Për kulturën 829 artikuj, portrete 797 artikuj, për problematika të ndryshme 621 artikuj, për krijimtarinë 432 artikuj, mbi veprimtari të ndryshme 392 artikuj, mbi historinë e gjeografinë 361 artikuj dhe mbi arsimin 98 artikuj. Te gjithë i falënderojmë për kontributin e tyre.



VIT TË BEKUAR DUKAGJIN - PO ECIM DREJT RRUGËS SË JETËS

BEKOJE, SHPIRTI IM ZOTIN, / DHE
KREJT QENIA IME EMRIN E TIJ TË
SHENJTË.

*Bekoje, shpirti im Zotin
e mos I harro bamirësit e tija
(Psalmi 103)*

Le te jenë këto vargje të psalmistit refreni i jetës tonë. E lëvdojmë dhe falënderojmë Zotin për jetën dhe të qenurit si dhe ku jemi.

E falënderojmë Zotin për krejt jetën. Por në ndërrimin e këtyre viteve e falënderojmë për vitin 2023, që për Dukagjinin dhe dukagjinast qe vite i bekuar. I lutemi Zotit që viti që sapo kemi filluar të jetë edhe më i bekuar.

SEMINAR NDËRKOMBËTAR "XHUBLETA MES SË SHKUARËS DHE TË ARDHMES"

- "IL MARE DEI
MESTIERI" -

Në datën 14 dhjetor 2023, në sallën qendrore në ambjentet e Universitetit "Luigj Gurakuqi", Shkodër u zhvillua veprimtaria, me temë: "Xhubleta mes së shkuarës dhe të ardhmes", me një pjesëmarrje të madhe nga të gjithë aktorët dhe faktorët në fushën e trashëgimisë kulturore, artizanatit, drejtues vendorë, profesorë, mësime dhënë, studentë dhe drejtues shoqatash kulturore dhe artizanale brenda dhe jashtë Shqipërisë. Veprimtaria ishte në nivel ndërkombëtar ...

GJERGJ KASTRIOTI- SKËNDERBEU, FIGURË E NDRITUR E HISTORISË KOMBËTARE

Në kuadër të 556 vjetorit të vdekjes së Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, shkolla 9-vjeçare "Gjergj Kastrioti", në qytetin e Lezhës, me drejtoreshën e palodhur, znj. Dije Zefi, ka përkujtuar me një veprimtari të larmishëm letrarokulturor 556 vjetorin e vdekjes së Heroit tonë kombëtar Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, me nxënësit e kësaj shkolle dhe mësuesit e tyre, një shkollë që mban me nder e krenari emrin e këtij Heroi, me rezultate e cilësi në arsim.

Veprimtari e bukur dhe i larmishëm, në të cilën nxënësit interpretues ishin veshur edhe me kostume kombëtare të përgatitur nga mësuesit e kësaj shkolle, me iniciimin dhe mbështetjen si kurdoherë të drejtueses së kësaj shkolle znj. Dije Zefi evokuar jetën ...

FESTIVALI BURIMOR "TREVA" 2024

Është bërë traditë prej dy dekadash që grupi artistik "Treva" të organizojë festivalin burimor me krijimet më të mira të vitit, shfaqje, të cilat janë organizuar kryesisht në tempullin e artit e kulturës, në teatrin "Migjeni". Edhe këtë vit, në bashkëpunim me bashkinë Shkodër e drejtorinë e teatrit "Migjeni", grupi artistik "Treva" organizoj festivalin "Burimor -Treva 2024", që në kete vit ishte dhe 20 vjetori i këtij festivali.

Grupi muzikor "Treva" erdhi në 20 vjetorin e nates tradicionale më i këndshëm se asnjëherë, duke përcjellë folklorin, vlerat dhe autoktoninë e Dukagjinit në këngë, melodi, në varg, në veshje dhe në valle, duke sjellë në skenë më të mirët e folklorit të Veriut, duke promovuar krijimet e interpretimet e tyre më të mira burimore, duke e kthyer këtë natë në një manifestim të madh kulturor e artistik, duke e pasuruar trashigiminë kulturore e folklorike të Dukagjinit e të Veriut.

Realizimet e vitit 2023, bazament i rëndësishëm për realizimin e misionit të SHAD dhe programi për vitin 2024

Të nderuar anëtare e anëtarë të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini"!

Të nderuar miq të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini"!

Të nderuar dukagjinat kudo ndodheni!

Në emër të Kryesisë së SHAD, ju informojmë mbi realizimin e programit për vitin 2023 dhe mbi programin e shoqatës për vitin 2024.

*Detyra kryesore e Kryesisë ka qene vijimi i botimit të gazetës "Dukagjini".

Gazeta "Dukagjini", në XXI vjetorin e botimit të saj mbërriti në botimin e 242 numrave, që do të thotë, në 242 muaj nuk është ndalur asnjëherë në saj të punës së palodhur e mjaft të përgjegjshme të Redaksisë së gazetës dhe bashkëpunëtorëve të saj. Janë afruar te gazeta "Dukagjini" 625 autore me nga një artikull dhe deri me 262 artikuj nga publicisti Prele Milani. Gjithsej 3 530 artikuj të ndryshëm sipas objekteve kryesore: Për kulturën 829 artikuj, portrete 797 artikuj, për problematika të ndryshme 621 artikuj, për krijimtarinë 432 artikuj, mbi veprimtari të ndryshme 392 artikuj, mbi historinë e gjeografinë 361 artikuj dhe mbi arsimin 98 artikuj. Te gjithë i falënderojmë për kontributin e tyre.

Gazeta "Dukagjini" nuk mund të botohej pa kontributin financiar të 103 mundësorëve nga 2 000 leke e deri në 1 550 000 leke, gjithsej 5 054 442 leke. Për vitin 2023 kane kontribuar: Lulash Gjeloshi (Martini), Familja Nikolin Kulla, Petri Sokoli, Kole Sukullari, Anton Kosteri, Tome Arra, Agim Hasanaj, Aleks Martini (Bardhoja), Prof. Dr. Vukasan Kola, Nikolin Gjeloshi, Mark Rupa dhe Sadik Guri, me një kontribut financiar të përgjithshëm 246 000 lekë. I falënderoj për kontributin e tyre financiar dhe i uroj "Paçin e Dhënçin!"

*Me 15 janar 2023, dite e Diele, Shoqata Atdhetare "Dukagjini", në bashkëpunim me Drejtorin e Bibliotekës "Marin Barleti", zotin Maxhid Cungu, organizoi ceremoninë e promovimit e tre vëllimeve me poezi, të autorit Ramush Nikçi, me banim në Pejë.

*Me datën 20 Mars 2023, Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Shkëlqesia e Tij, Zoti Bajram BEGAJ, priti një përfaqësi të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini". Ishte një takim mjaft i përzemërt, me përfaqësinë e Shoqata Atdhetare "Dukagjini": Ndue Sanaj, Gjergj Leqejza, Agron Hasanaj e Zef Gjeta

*Kryeredaktori i gazetës "Dukagjini" dhe publicisti i njohur, Prele Milani, fitues i Çmimit "Hamit Boriçi", në edicionin i 6-të.

*U përkujtua, me 21 maj 2023, 50-vjetori i revoltës së të burgosurve politikë të ish burgut të Spaçit, i cili u organizua nga Komisioni për Drejtësi e Paqe, revoltë e cila tronditi regjimin komunist të kohës dhe u shoqërua edhe me revoltën e të burgosurve të ish burgut të Qafë Barit. Re-

volta e Spaçit u shtyp me dhunë

*Lazer Kodra, me datën 28 Prill 2023 në bashkëpunim me drejtorinë e shkollës së mesme profesionale, promovon dy libra. Veprat me tematike proze, me titull "Hije pallati" dhe me poezi, me titull "Rozafa e Idhnueme", të cilat erdhën nga një frymëzim i shkëlqyer i autorit në vijueshmërinë e veprave të tij, që vijojnë të përcjellin emocione tek lexuesi. Me këtë



rast, poeti e publicisti Lazer Kodra nga Kryesia e SHAD, vlerësohet me titullin "Mirënjohja Martin Camaj"

Më datë 12 prill 2023, Këshilli i Paqes Shkodër organizoi konferencën me temë "Paqja fillon nga shërbimi për të tjerët", në ambientet e Hotel "Colosseo", ku morën pjesë rreth 90 përfaqësues të shoqërisë



civile, Ambasadorë për Paqes, miq dhe të ftuar të tjerë. Të jetuarit për hir të të tjerëve është motoja udhëheqëse e Federatës së Paqes Universale dhe e Ambasadorëve për Paqe. Ndue Sanaj, Kryetari i SHAD u nderua me titullin "Ambasador i Paqes Universale".

Me datën 29 prill 2023, dite e shtune u zhvillua Manifestimi tradicional "Zëri i

vëllazërisë-2023", organizuar nga Shoqata e miqësisë Kosovë-Malësi e Madhe "Martin Dreshaj" në bashkëpunim me Komunën e Deçanit. Shoqata Atdhetare "Dukagjini" u paraqit me një grup i kryesuar nga Kryetari i saj Ndue Sanaj, Konsulli i Nderit të Austrisë në Shkodër Gjergj Leqejza, rapsodët Kole Hasani dhe Gjon Kosteri, poeti Lulash Brigja dhe anëtarët e shoqatës Gjon Vojvoda dhe Kole Sukul-

priti disa mijëra burra e gra nga të gjitha trojet shqiptare për nderuar me homazhe e kujtesë tre martirët e anti-komunizmit. Me këtë rast, kryesia e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", familjen Progni e nderoj me titullin "Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini".

Me datën 9 Qershor 2023 në ambientet e fshatit të Paqes, Shoqata Atdhetare "Dukagjini", që në orët e para të mëngjesit hapi dyert e festës, të 20 vjetorit të themelimit të Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", duke ju uruar mirëseardhjen vëllezërve dhe motrave nga të gjitha trojet Shqiptare. Shumë prej të pranishmëve morën rrugën ndoshta pa agu dita e re, që ata të ishin nga më të parët në festë dhe kështu ndodhi pasi njëri pas tjetrit u bashkuam dasmorët e kësaj feste nga Peja, Vlora, Ferizaj, Gjilani, Lipjani, Deçani, Istogu, Tirana, Durrësi, Laçi, Lezha dhe Malësia e Madhe.

Me këtë rast, me vendim të Kryesisë së SHAD, nr. 275, date 17 maj 2023, u nderuan:

- A. Me titullin "Mirënjohja Mësuese Kushë Micja" të nderohen:
1. Jason Pjeter Rushaj, nxënës, pas vdekjes;
 2. Fran Lisi nga Shllaku, mësues në pensioni;
 3. Xhahid Bushati, mësues në Breg Lumi Shalë, shkrimtar dhe pensionist;
 4. Kolë Gjoka nga Lotajt, mësues në pension;
 5. Zija Vukaj, mësues në fshatin Ndreaj e Palaj në krahinën e Shoshtit, shkrimtar, përkthyes e publicist;
 6. Ndoc Zef Prendushi, nga Shllaku, mësues në pensioni;
 7. Mark Gjoni, nga Lotajt, mësues në pensioni;
 8. Emanuel Petrit Suka, rapsodi më i ri të Dukagjinit, nga Thethi.
- B. Me titullin "Anëtar Nderi i Shoqatës Atdhetare Dukagjini", të nderohen:
1. Mark Lule Vladaj, i krahinës së Shalës, pas vdekjes, pjesëtar në Lidhjen e Prizrenit;
 2. Marash Kola i krahinës së Shoshtit, pas vdekjes, pjesëtar në Lidhjen e Prizrenit;
 3. Gjekë Gega i krahinës së Shllakut, pas vdekjes, pjesëtar në Lidhjen e Prizrenit;
 4. Gjon Marashi, luftëtar në LANÇI, pas vdekjes;
 5. Balë Mark Milani, luftëtar në LANÇI, pas vdekjes;
 6. Kole Nosh Arrinaj, drejtues e deputet, pas vdekjes;
 7. Zef Gjelosh Arra, drejtues e deputet, pas vdekjes;
 8. Frashër Racaj (Sekretari i shoqatës "Martin Dreshaj" dhe Kryetari i Lëvizjes për Shqipërinë e Bashkuar;
 9. Mjeshtrin e Madh-Kantautori Rrok

lari. Pas nderimit të dëshmorëve në luftën për çlirimin e Kosovës, në Glllogjan, me propozim të kryetarit të shoqatës "Martin Dreshaj" u nderuan dëshmorët: Nuredin Mehmet Gërvalla, Ramush Hysen Shala dhe Hilmi Isa Shala, me titullin "Mirënjohja Mehmet Shpndi"; me titullin "Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini" u

nderua veprimtari Ali Tahiraj, veprimtarja Bahrie Shoshka dhe Këngëtarja Besnike Bërdynaj; me titullin "Anëtar Nderi i Shoqatës Atdhetare Dukagjini", u nderua zoti Ramush Harajdinaj, zonja Flora Borovina e historiani Fari Xh. Xharra. Me logun e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", u nderua Komuna e Deçanit. Me datën 7 maj 2023, familja Progni

- Gjelaj, kryetari i shoqatës “Bilbilat”;
- Gjekë Tomë Boka, Mjeshtri duar artë, pas vdekjes;
 - Gjergj Mark Suka, rapsod (lahutar), pas vdekjes;
 - Gjergj Ndreka Luca, artist dhe biznesmen i suksesshëm.

C. Me titullin “Nderi i Shoqatës Atdhetare Dukagjini”, të nderohen:

- Gjon Kosteri, anëtar i SHAD, veprimtar dhe rapsod;
- Roza Pjetri, anëtare e kryesisë së SHAD;
- Luigj Mila, anëtar i SHAD, Sekretar i Komisionit për Drejtësi e Paqe;
- Mark Dreni, N/kolonel, në pension, me banim në Nju-Jork;
- Prele Milani, N/kryetari i SHAD, studiues, poet e publicist;
- Suela Ndoja, anëtare e kryesisë së SHAD, Kryeredaktore e gazetës “Dukagjini”.

D. Me titullin “Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini” të nderohen:

- Ismet Dema, këngëtar, nga komuna e Istogut;
- Fatmir Berisha, këngëtar nga komuna Klinë;
- Xhemajl Berisha, këngëtar nga komuna e Gjinalit;
- Florim Nikçi, valltar i ansambllit “Rugova”, nga Peja;
- Fadil Grabovci, aktor dhe Drejtori i teatrit “Aleksandër Moisiu”, në Peja;
- Besim Zabelaj, këngëtar e aktor i teatrit “Aleksandër Moisiu”;
- Motër Dukate Radoja, me origjinë nga Gimajt;
- Ndoc Fushën, kryetari i Shoqatës kulturore “Besa Shoshi”;
- Diana Bungu, veprimtare;
- Mhill Shkami, intelektual e biznesmen i suksesshëm;
- Mark Rupa, intelektual e veprimtar me kontribute të rëndësishme;
- Nikolin Shqau, biznesmen i suksesshëm;
- Preke Gjonaj, Major në rezerve, me banim në Kanada;
- Sokol Sterbyqi, veprimtar, me banim në Kanada;
- Marjana Koçeku, Malësorja e re, veprimtare;
- Gëzim Çardaku, veprimtar, me banim në Zvicër;
- Lazer Kulla, veprimtar, me banim në Kanada;
- Petrit Sokoli, veprimtar, me banim në SHBA;
- Tonin Deda, N/Kryetari i Bashkisë Shkodër;
- Gjin Niklekaj, Kryetari i pari i Shoqatës “Nikaj-Merturi”, bashkëpunues.

*Me datën 9 korrik 2023, dite e Di-ele, në Theth u zhvillua “Festa e Alpeve” 2023. Një veprimtarie festive e organizuar nga Bashkia Shkodër, Administrata e Zonave të Mbrojtura, me objektiv promovimin e vlerave kulturore, turistike e artistike në zonën e Dukagjinit. Si gjithmonë Shoqata Atdhetare “Dukagjini” një zë i fuqishëm për vendlindjen! Një organizim i suksesshëm nga drejtuesja organizative zj. Aurora Piroviq dhe grupi i saj. Pjesëmarrje nga Peja, Gucia, Malësia e Madhe, e trevat e tjera të Veriut.

*Me 16 korrik 2023, u përkujtua 108 vjetori i rënies së Tribunit të Vegjëlisë, Mehmet Shpendi, pranë monumentit të tij dhe u festua 60 vjetori i lindjes së gazetarit Zef Nika.

*Në Oda Pleqnare e Junikut u mbajt edicioni i 10-të i Manifestimi “Dita e Plisit”, organizuar nga: Komuna e Junikut, Oda Pleqnare e Junikut, në bashkëpunim me Lidhja e Krijuesve Shqiptarë në Mërgatë, Shoqata Mbarëkombëtare “Plis Bardhët” dhe Shoqata “Dardania” Mannheim. Shoqata Atdhetare “Dukagjini” Shkodër si gjithmonë ishte e ftuar dhe mori pjesë. Mesazhi dhe ideja e veprimtarisë ishte: - Ruajtja e trashëgimisë kulturore artistike të Kombit tone, - Bashkërendimi i punës për të dorëzuar në UNESKO dosjen për Plisin e Bardhë.

Me këtë rast, nga Kryesia e Shoqatës u nderuan, me titullin “Anëtar Nderi

*Shoqata e Vëllazërisë Kosovë-Malësi e Madhe “Martin Dreshaj” duke vijuar veprimtaritë e saj kulturore, me datën 25 nëntor 2023, në Pejë u mbajt Manifestimi kulturor “Rreth Flamurit të Bashkuar”. Në këtë veprimtarie përveçse ju kushtua krijuesve, por u promovua libri “Falemin-derit miq!” i autorit Luigj Shyti dhe “Dukagjini, Shqipëria ime aty”, pjesa e III e autorit Ndue Sanaj, me vendim të kryesisë ju dha titulli “Mirënjohja Mehmet Shpendi” dëshmorit poet Ymër Lesheni, të cilin e dorëzoi N/kryetari i SHAD, poeti e studiuesi Prele Milani. Gjithashtu z. Aleks Dushi u nderua me titullin “Anëtar Nderi i Shoqatës Martin Dreshaj”.

E gjithë kjo veprimtarie nuk mund të realizohej pa kontributin financiar të dukagjinave kudo ndodhen, të cilët paraq-



i Shoqatës Atdhetare Dukagjini”: Aktori e kryetari i grupit “Plise Bardhet”, Ismet Krasniqi; me titullin “Mirënjohja Martin Camaj”: Poetja e veprimtarja Migena Arlati, poeti e veprimtari Agim Desku; Me titullin “Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare

iten më poshtëm:

- Anton Kosteri 50500 leke
- Vilson Peshkaj 2000 leke
- Prele e Mri Kroj 5000 leke
- Lulash Gjeloshi 20500 leke
- Kole Cardaku 12800 leke



Dukagjini” Oda pleqnare e Junikut, Lidhja e Krijuesve Shqiptarë në Mërgatë, gazetari i TV “FONTANA” Zeqir Mehmetaj.

*Me 28 tetor 2023 morëm pjesë në Festën e gështenjës së Shllakut, në vendin Kisha e shkolla në Ukbibaj. SHLLAKU E KTHEN NË TRADITË FESTËN E “GËSHTENJËS” Shllaku i historisë, i kulturës dhe traditës, Shllaku i burrave trima dhe intelektual.

- Gjergj Leqejza 35000 leke
- Edmond Tërthorja 20000 leke
- Sokol Sterbyqi 18928 leke
- Preke Gjonaj 18928 leke
- Mark Rupa 20500 leke
- Nikolin Gjeloshi 20500 leke
- Fran Shytani 11000 leke
- Mhill Shkami 30000 leke
- Tome Arra 20500 leke
- Aleks Martini 20900 leke
- Petrit Sokoli 21000 leke

- Florenc Buxha 11000 leke
- Pal Lera 29700 leke
- Nikolin Kulla 20500 leke
- Kole Sukullari 61500 leke
- Engjell Radohima 50000 leke
- Viktor Arrinaj 70000 leke
- Roza Pjetri 10000 leke
- Agim Hasanaj 25000 leke
- Gjon Dukgilaj 10000 leke
- Prele Milani 10000 leke
- Vuksan Kola 25000 leke
- Agron Hasanaj 7000 leke
- Sadik Guri 20500 leke

Nga shumë e përgjithshme prej **678356 lekë**.

Nga kjo shumë, 246 000 leke janë shpenzuar për botimin e 12 numrave të gazetës “Dukagjini” për vitin 2023. Pjesa e tjetër është shpenzuar për organizimin, përgatitjen e zhvillimin e veprimtarive të shoqatës dhe për pjesëmarrjen në veprimtaritë e tjera sipas ftesave që i janë bërë shoqatës.

Të gjithëve ju falënderojmë për kontributin tuaj financiar shumë të çmuar, që brezat do të jenë shumë krenar për kontributin tuaj. Gjithmonë paçi e dhënçi për mirë!

Njëkohësisht falënderojmë të gjithë miqtë, bashkëpunëtorët që na kanë mbështetur me mjete për të lëvizur nga një rajon në tjetrin, nga një vend në tjetrin, me shpenzimet e tyre!

Kjo punë e këtij viti është një bazë nise për punë më të plota për vitin 2024, për punë më të mirë në realizimin e MISSION-IT të Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”!

Mbështetur në arritjet e këtij viti, në vitin 2024 do të punohet me këtë program:

- Vijimi i botimit të gazetës “Dukagjini”, me 16 faqe, e vijueshme, Redaksia ...
- Studimi mbi vijimin e shkollimit të fëmijëve në zonën tonë, në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore të Rajonit, dhe propozimi i masave konkrete strukturave përkatëse, për ndryshimin e gjendjes, qershor-korrik 2024, Seksioni i shkollës.
- Marrja pjesë në gjitha ftesat e shoqatave analoge dhe zgjerimi i veprimtarive në hapësirat shqiptare, por dhe ne që duhet të ftojme, për të bashkëpunuar, sipas rastit, seksioni i veprimtarive.
- Veprimtari festive kushtuar 7-8 Marsit, në veçanti për nderimin e nxënësve të shkëlqyer në mësim të klasës së 9-të dhe të vitit të katërt të shkollës së mesme dukagjinave, seksioni i shkollës, gruas dhe veprimtarive të SHAD.
- Promovime të botimeve të reja, sipas rastit ...Seksioni i librit;
- Përfundimi i rindërtimit të monumentit të albanologut Martin Camaj dhe ri-inaugurimi i tij, me rastin e 99 vjetorit të lindjes së tij, brenda vitit 2024, Kryesia

Në emër të SHAD, ju uroj vitin e Ri-2024, një vit të mbare në jetën tuaj, në jetën familjare, në punë dhe kudo për të bërë jetën më të mirë, më të begatë!

**Ndue Sanaj,
Kryetari i SHAD**

Vit të bekuar Dukagjin - Po ecim drejt rrugës së Jetës

BEKOJE, SHPIRTI IM ZOTIN, / DHE KREJT QENIA IME EMRIN E TIJ TË SHENJTË.
BEKOJE, SHPIRTI IM ZOTIN E MOS I HARRO BAMIRËSIT E TIJA (PSALMI 103)

Le te jenë këto vargje të psalmistit refreni i jetës tonë. E lëvdojmë dhe falënderojmë Zotin për jetën dhe të qenurit si dhe ku jemi.

E falënderojmë Zotin për krejt jetën. Por në ndërrimin e këtyre viteve e falënderojmë për vitin 2023, që për Dukagjinin dhe dukagjinat qe vite i bekuar. I lutemi Zotit që viti që sapo kemi filluar të jetë edhe më i bekuar.

Ndër virtytet më të mëdha është Dashuria, e cila këtë vite u shkund nga gjumi pothuajse gjysmëshekullor dhe më jehonën e saj na bashkoj të gjithëve, që me urti, bashkim dhe vendosmëri ja dolën më në fund ti themi vetës dhe krejt botës se Dukagjin ja ku është i bashkuar dhe me Paqe po kërkon vëmendjen dhe të drejtat që Zoti ja ka dhuruar si gjithë të tjerëve. Me moton "Dukagjin Deli Zot Vetit" u bë kambana e parë që shumë shpejt bashkoj rreth vetes Dukagjinat, të cilët të gërshetuar shumë mire, me njëri -tjetrin dhanë mendimet dhe morën vendimet në mënyrën më demokratike. Nga ky bashkim u forcua dhe më shumë dhe u zgjua ndjenja e të qenurit dukagjinat. U thyen barrierat që koha me dredhin e saj e kishte mbështjellë Dukagjinin në mjegullinë e saj. Atë çka shumë vite e kishin shkatërruar e braktisur ky Bashkim kërkoj më vendosmëri rikthimin në Dukagjin, i cili mundësohet me Rrugën, e cila ka marrë emrin deri tani "Rruga e Vdekjes". Me plagët e hapura të shpirtit Dukagjini u bashku për ti thanë vetës dhe krejt botës se tash "thika ka shkua në palcë" e shpirti s'duron ma.

Në deklaratat dhe Peticionin e hartuar nga grupi nismëtarë u kërkua Rruga e Dukagjinit në gjurmët ekzistuese dhe kjo u mbështet në dy protesta dhe Peticionin, i cili u firmos me shumë se 6 mijë firmëtarë. Koordinim i takimeve dhe protestave nga grupi nismëtarë gjeti mbështetjen jo vetëm të Dukagjinit, por edhe miqve dhe dashamirëve të tij.

Besojmë në Zotin se, tashmë Rruga e ka marrë vëmendjen e duhur, që më hartimin dhe prezantimin e projektit në kohë rekord. Falënderojmë dhe vlerësojmë fillimin e punimeve për rikonstrukcionin e rrugës dhe presim që Projekti i paraqitur të zbatohet sipas afatit të paraqitur.

Protestat e 20 Shkurtit 2023 dhe 12 Marsit 2023 u vlerësuan si protestat më demokratike të organizuara ndonjëherë në vendin tonë. Organizimi dhe masiviteti i tyre, theu shumë barreja dhe solli bashkim, i cili kishte si themel Dashni ndaj vetës dhe Dukagjinit. Tashmë Pranvera ka fillua me ardhe në Dukagjin. kjo nisem krahas ecurisë së qëllimit kryesor-Rrugës- na bashkoj në punë, sepse vetën dukë punuar së bashku do rikthehem në trojet e të parëve tone, në trojën tonë më krenarë. Vetën dukë i rindërtuar Kullat në trojet e të parëve tanë i japim jetë vetës dhe

Dukagjinit. Duke, dëgjuar, pranuar dhe bashkëpunuar me njëri -tjetrin do ecim përpara. Në kreshtat e Dukagjinit rrezatojnë shumë kryqe, të cilat na kujtojnë pse të parët tanë u vendosën në zemrën e këtyre kreshtave. Identiteti jonë vlerësohet më së

Djali Planit, Kolë Dushku këtë vit rikonstruktoj Kaplene varreve dhe varrezat. Po rikonstruktohen shumë kulla dhe me iniciativa fisnore apo edhe individuale, po hapen rrugë lagjesh dhe fshatrash. E gjithë kjo së bashku me iniciativat e këtyre

dashur vetën dhe familjen, duke i dhuruar dashni babës dhe nënës, gruas dhe fëmijë, vëllait dhe motrës.

Familja Dukagjinase ka jetuar gjithmonë me virtytet të bekuara, të cilat e kane rritë dhe majtë të forte dhe të pastër.



miri më rivendosjen e këtyre Kryqeve dhe përmendores së Martirëve të Kishës me origjinë nga Dukagjini. Nisem kjo e bijve të Dukagjinit me banim në Amerikë, Gjini

tre -katër viteve të fundit të bëjnë të ndihesh krenare dhe të ringjallet besimi dhe dëshira se ne, brezi ynë duhet ti rikthej Dukagjinit shpirtin që koha ja shpërndau



Markaj dhe Ded Prendajt. Rikonstrukcionin i disa Kishave dhe Kapelave me iniciativa të vete Dukagjinave vjen si shenje falënderimit ndaj Zotit dhe të parëve.

anë e mbanë botës. Viti ka katër stinë, por Pranverën Dukagjinit ja dhurojnë ne Dukagjinat. Duke falënderuar Zotin, për jetën dhe të qenurit Dukagjinat. Duke e



Ti lamë vendin që i takon Zotit në familjet tonë dhe mos ta nxjerrim jashtë MODE. Të duam dhe vlerësojmë çdo pjesëtarë të familjes, sepse jemi të gjithë të barabartë. Gruaja dhe fëmija nuk janë instrument i të zotit të shtëpisë, por janë bekimi i Zotit për të. Nëna së bashku me gjirin ti dhuroj fëmijës mësimin për dashni, respektin, punën dhe bashkëpunimin. Prindërit të jenë akrepat e sahatit që mbasi kohen në familje dhe të përçojnë vlerat që i trashëguam nga të parët.

Të jesh dukagjinat do të thotë të duash Zotin, i cili të ka dhuruar familjen dhe të qenurit dukagjinat. Trimnia ma e mire e Dukagjinave sot është të jemi së bashku, të mësojnë dhe punojnë duke qenë krenar për të mirën e njeri -tjetrit.

Zoti e ka dashtë dhe e donë fort dukagjinat, që nuk e mohoj kurrë as pas konopit as para grykës së pushkës. Të jeni të bindur së gjaku i të parëve tanë i derdhun për Fe e Atdhe s' ka me hup Zoti kurrë, por ka me e shumëfishua me jete e me Bekime për Dukagjinin dhe Dukagjinat.

Viti 2023 e ka çel shtegun e Bashkimit dhe Bekimit. Në këtë vite që sapo kemi filluar le të ecim të bashkuar me dashni, pranin dhe bashkëpunim me njëri -tjetrin, sepse rruga do jetë e gjatë dhe bukur. Do jetë RRUGA E JETËS.

Përgatiti: **Roza Pjetri**

DISKUTOHET MEDIA, PAQJA DHE SIGURIA NË KONGRESIN E 50-të UPF SHKRUAN NGA DAKAR ARBEN LAGRETA*

“Media, paqa dhe siguria” ishte tema e Kongresit të 50-të të Unionit Ndërkombëtar të Shtypit Frankofon – UPF, i cili u mbajt në Dakar nga 9 deri në 12 janar të këtij viti. Ditën e çeljes zyrtare të kësaj ngjarjeje ndërkombëtare të përvitshëm ishte i pranishëm edhe Presidenti i Senegalit, Macky Sall, i cili përshëndeti gazetarët e pranishëm të UPF me një fjalim.

Ishin të pranishëm edhe Presidenti Ndërkombëtar i UPF, senegalezi Madiambal Diagne, Madiambal DIAGNE, Sekretarja e Përgjithshme Ndërkombëtare e UPF Zara Nazarian, i dërguari i Asamblesë Parlamentare të Frankofonisë, deputeti Bruno FUCHS si dhe i ftuari i Nderit të Presidentit të Senegalit, ish Presidenti i Kepit të Gjellbër Jorge Carlos de Almeida Fonseca (2011-2021).

Ndërkohë, duke shfrytëzuar hapësirën kohore për t'i drejtuar pyetje apo edhe mesazhe këtij paneli, ndërmjet të tjerash u shpreha:

“Jo vetëm Afrika ka probleme në kuadër të drejtave të njeriut si dhe të lirisë së shtypit dhe të shprehjes së mendimit, por edhe në disa vende të Ballkanit Perëndimor si Shqipëria, Bosnja dhe Serbia, në të cilat të paktën që prej 15 vjetësh ka një rikthim të tendencave autoritariste dhe një regres të theksuar për sa i takon lirisë së shprehjes së mendimit, të shtypit dhe shkeljes së drejtave demokratike dhe ekonomike të gazetarëve, por edhe të drejtave të njeriut në përgjithësi. E gjitha kjo po ndodh në një vend si Shqipëria, e cila është në mes të Evropës ose vetëm 1 orë e gjysme me avion larg nga Parisi. Sipas raportit të fundit të Reporterët pa Kufij (Reporter sans frontiere) Shqipëria ka humbur 20 vende në klasifikimin e përgjithshëm botëror për sa i takon lirisë së shtypit dhe të shprehjes së mendimit, duke e radhitur atë të fundit në Ballkan dhe në nivele të përafërt me vendet e fundit të Afrikës. Në këtë këndvështrim Shqipëria ndodhet në Evropë vetëm në aspektin gjeografik.

Paneli i përbërë nga personalitetet e mësipërme si dhe audienca prej më shumë se 200 gazetarësh frankofonë të ardhur nga 4 kontinente si dhe gazetarët vendas u informuan për paradoksin që po luhet të paktën në dekadën e fundit në rajonin historikisht të trazuar dhe problematik të Ballkanit Perëndimor, në

të cilin po llobojnë fort për të influencuar krahas Bashkimit Evropian, tashme edhe Rusia, Kina dhe Turqia. Duke e parë në këtë këndvështrim kërkova po aty që rajoni i Ballkanit Perëndimor të ketë më shumë hapësirë në projektet dhe veprimtaritë ndërkombëtare të UPF e jo vetëm të presim një vit për tu takuar drejtpërdrejt

Po kështu kishte edhe tryezë të përbashkët të rrumbullakët me temë “Media dhe terrorizmi” dhe “Vendi dhe roli që luan media në kohë lufte?”, e cila moderohet nga emra të njohur të lektorëve dhe të gazetarisë franceze dhe frankofone të eurozonës.

PRESIDENTI I UPF DIAGNE,
NJERIU I VITIT 2023 NE SENEGAL



Presidenti Ndërkombëtar i UPF, duke folur në Kongres



Lais Lawsan dhe Anani Sassau, dy gazetarë të arrestuar në Togo dhe më vonë të liruar, me ndërhyrjen ndërkombëtare...

nga kongresi në kongres.

Kanë përshëndetur gazetarët e pranishëm në Kongresin e tyre të 50-të Presidenti i Senegalit Macky Sall, Presidenti Ndërkombëtar i UPF Madiambal Diagne si dhe deputeti i Asamblesë Parlamentare të Frankofonisë Bruno Fuchs.

Kongresi i 50-te i shtypit frankofon i ka vijuar punimet në ditët në vijim ku isha përzgjedhur paraprakisht nga organizatorët në panelin: “Manipulimi dhe dezinformimi: Si duhet rezistuar përballë tentativave për kontrollin e medias” panel i cili dominohej nga emra të njohur të gazetarisë investigative në eurozonën frankofone.

-Sipas një anketimi të gazetës së përditshme senegaleze Le Point

Presidenti Ndërkombëtar i Unionit të Shtypit Frankofon (UPF) Madiambal Diagne është shpallur “Njeriu i vitit” për vitin 2023 në Senegal. Në këtë përfundim ka arritur gazeta e përditshme senegaleze “Le Point” pas një anketimi të zhvilluar me këtë rast.

Ajo që ndikoi më shumë në akordimin e këtij titulli ishte angazhimi i tij i menjëhershëm për të liruar 2 gazetarë togolezë nga burgu, anëtarë të Seksionit Togolez të UPF një muaj më parë. Këta të fundit u akuzuan me pa të drejtë gjoja për përhapje të

informacioni të rremë kur në fakt zbuluan dhe publikuan një artikull ku dyshuan për ekzistencën e 400 milionë frangave togoleze kesh në shtëpinë e Ministrisë të Urbanistikës së Togos. Në këto kushte Madiambal Diagne udhëtoi menjëherë drejt kryeqytetit të Togos, Lone, ku edhe u takua me ministrin Kadzo Adedze, me të cilin negocioi qysh në krye të herës për lirim të tyre. Nëse nuk do të kishte edhe autoritetin e tij si gazetar investigativ si dhe President Ndërkombëtar i Unionit Ndërkombëtar të Shtypit Frankofon (UPF), kjo organizatë ndonëse ndërkombëtare gazetarësh dhe e shtrirë në katër kontinente do ta kishte shumë të vështirë e në mos të pamundur për lirim të dy gazetarëve togolezë Loic Laëson dhe Anani Sossou.

AMBASADA FRANCEZE

NUK JEP PRITJE PËR GAZETARËT

Për herë të parë në historikun e UPF, Ambasada e Francës në Dakar nuk dha kësaj here një pritje me rastin e Kongresit të 50-të të Shtypit Ndërkombëtar Frankofon, për më tepër në një kongres jubilar. Në bazë të rregullit diplomatik, për të pasur një reception në ambasadë duhet bërë formalisht një kërkesë, por duket se kjo nuk ishte bërë nga ana e dy drejtuesve kryesorë të UPF, Presidentit Ndërkombëtar dhe Sekretares së Përgjithshme Ndërkombëtare. Kërkova shpjegime për këtë detaj në mbledhjen e Komitetit Ndërkombëtar, në të cilin marrin pjesë të gjithë kryetarët e seksioneve, por nuk u dha një përgjigje e plotë me arsyetimin se nuk jemi mbledhur për këtë temë..

Por ajo që vërejtëm të gjithë, kush më shumë e kush më pak është fakti se ndërmjet drejtuesve të UPF dhe Francës ka një ftohje. Arsyet i dinë ata, por një gjë dihet publikisht. Kongresi i 50-të i UPF ishte planifikuar që të mbahej në vjeshtë të vitit 2023 në Nigeri, por u anulua. Kjo, për arsye se në atë vend ka një grusht shteti të shkaktuar nga ndërhyrja e trupave komando Égner të Rusisë çka nuk garantonte siguri në mbajtjen e këtij takimi ndërkombëtar të UPF.

*Autori është Kryetar i Seksionit Shqiptar të Unionit Ndërkombëtar të Shtypit Frankofon (UPF) dhe gazetar investigativ pranë Asgjesisë Ndërkombëtare të Investigimit “Stop krimi”, me seli në Tiranë.

Prezantohet në “Shqip Ville” në zemër të Brukselit, libri “Rrethimi” i gazetarit, krijuesit dhe moderatorit Enkel Demi

Në Grand Place, në qendër të Brukselit, bashkësia shqiptare ka një qendër kulturore “Shqip Ville”, ku shqiptaret, fale kontributit të gazetares Ledia Canaj ka ngritur një qendër kulturore, e cila çdo ditë e më shumë po bashkon shqiptaret në njohjen e kulturës shqiptare.

Këto dite, në “Shqip Ville”, në praninë

e gazetarëve, studiuesve, shkrimtarëve e dashamirësve të librit u bë prezantimi i librit “Rrethimi” i gazetarit, krijuesit e moderatorit Enkel Demi.

I njohur prej shumë vitesh në gazetari në disa media shqiptarë, tashme i përqendruar edhe në proze. Në përmasat e tij të shkrimtarit, ai prezantohet me logen me famë ndërkombëtare Tome Kuka.

Ngjarjet e romanit janë vendosur në qytetin e Shkodrës. Ai i kushtohet ngjarjeve historike më të jashtëzakonshëm të



Shqipërisë, që është Rrethimi i Shkodrës prej trupave malazeze nga 28 tetori 1912 deri me 23 prill 1913 gjate luftës së parë Ballkanike.

Sipas autorit, libri nuk është një roman historik, por është një sajese letrare. Me këtë libër, autori ka dashur gjithashtu tu bëjë homazh të gjithë atyre fotografeve të Shkodrës, që mbanin mbiemrat si Marubi, Kodheli, Idromeno, Pici, e të

tjerë, të cilët i hapen një derë qytetërimi botes sonë të prapambetur. Në këtë libër, jeta shqiptare rrëfëhet me një ndershmëri

të rralle.

Personazhet e këtij Liberi janë sajuar, duke u mbështetur në kronikat e luftës siç është Tome Kuka, Gjon Pali dhe e bija e Kole Maçes.

Ky roman shprehe mirënjohje për një qytet si Shkodra, duke e vëzhguar atë në një qoshe nate e dite, duke përcjellë personazhet e jetës së qytetit, duke përdorur mjaft bukur gjuhën shkodranishte, si dhe duke pasqyruar në art trishtimin, vuajtjen, tradhtinë, dashurinë e shpresën në kohë lufte.

Një roman me nota të forta emocionale, i kuptueshëm dhe i botuar për publikun nga shtëpia botuese “Pegi”, Tirane 2022.

Përgatiti Zef Nika, Bruksel

SEMINAR NDËRKOMBËTAR “XHUBLETA MES SË SHKUARËS DHE TË ARDHMES” - “IL MARE DEI MESTIERI” -

Në datën 14 dhjetor 2023, në sallën qendrore në ambjentet e Universitetit “Luigj Gurakuqi”, Shkodër u zhvillua veprimtaria, me temë: “Xhubleta mes së shkuarës dhe të ardhmes”, me një pjesëmarrje të madhe nga të gjithë aktorët dhe faktorët në fushën e trashëgimisë kulturore, artizanatit, drejtues vendorë, profesorë, mësimdhënës, studentë dhe drejtues shoqatash kulturore dhe artizanale brenda dhe jashtë Shqipërisë. Veprimtaria ishte në nivel ndërkombëtar, pasi aty morën pjesë të ftuar nga vise të ndryshme të vendit (kryesisht nga Veriu i Shqipërisë), si dhe studiues të fushave të ndryshme që kanë të bëjnë me traditën dhe veshjen e xhubletës, por edhe të ftuar nga Mali i Zi dhe nga Kosova.

Po ashtu, në hyrje të sallës, në hollin qëndror të Universitetit “Luigj Gurakuqi” u paraqit ekspozita: “Xhubleta- Entropia” me autor Fatmir Juka, ekspozitë që qëndroi e hapur gjatë gjithë paradites së datës 14 dhjetor 2023.

Seminari u ndoq me shumë interes nga të pranishmit, po ashtu me vëmendje u ndoqën edhe kumtesat e mbajtura nga ekspertë të fushës së trashëgimisë, etnografë, profesorë përmes të cilëve u trajtuan aspekte të ndryshme të kësaj vlere të trashëgimisë kulturore siç është veshja e xhubletës, me tematikat: Historiku i përfshirjes së xhubletës në UNESCO, UNESCO dhe xhubleta. Ornamentet dhe simbolikat e pranishme në xhubletë. Trashëgimia kulturore midis Italisë dhe Shqipërisë. Xhubleta veshja 4000 vjeçare e shqiptarëve, Motive popullore, xhubleta e përcjellë në breza. Xhubleta në Malin e Zi, Xhubleta në Kosovë. Të gjithë kumtuesit në seminar theksuan faktin se xhubleta është një veshje që rrezikon egzistencën e saj ndaj duhen marrë masa imediate për të transmetuar dijetë të tek gratë dhe vajzat e reja në mënyrë që kjo veshje të gjallojë ndër breza.

Xhubleta është një veshje e lashtë e cila është përdorur në brigjet e mesdheut rreth 4000 vite më parë dhe kjo është e vërtetuar në terrakotat e zbuluara nga gërmimet arkeologjike në brigjet e mesdheut, por që tashmë gjallon vetëm në Shqipërinë e veriut.

Trajnimiti “Xhubleta - mes së shkuarës dhe së ardhmes” me datë 15. 12. 2023 u zhvillua në ambjentet e këshillit bashkiak Malësi e Madhe me një pjesëmarrje të konsiderueshme nga gra dhe vajza të interesuara për tu njohur me vlerat kulturore, etnografike dhe me procesin e dijetë të punimit të xhubletës.

Veprimtaria u hap me fjalën përshëndetëse të kryetarit të bashkisë Malësi e Madhe z. Tonin Marinaj, i cili ndërmjet të tjerave, vlerësoi si shumë të rëndësishëm zhvillimin e këtij seminari trajnues dhe

theksoi faktin e domosdoshmërisë së transmetimit të dijetë të punimit tradicional të xhubletës nga dijetë të tona, tashmë në numër tejet të reduktuar, tek gratë dhe vajzat e reja të krahinës së Malësisë së Madhe si një vazhdimësi



ndër breza e kësaj trashëgimie tashmë në mbrojtje nga UNESCO.

Pjesëmarrësit në trajnim u njohën me



historikun e xhubletës dhe gjendjen e saj në ditët e sotme, u njohën me rrugëtimin e regjistrimit të saj në UNESCO, u njohën me tipologjitë e xhubletës, materialin përbërës, procesin e dijetë të punimit në aspektin teorik përmes një prezantimi dhe shpjegimi në detaje, gjithashtu përmes grave që dinë dijetë të punimit të saj u realizua edhe demonstrimi praktik i realizimit të saj dhe rëndësinë që ka ky proces i mësimin të dijetë të punimit për gratë dhe vajzat në mënyrë që kjo veshje të transmetohet

përmes tyre në breza. Këto veprimtari dhe trajnime dy ditore u organizuan nga IKR me financim të AICS Tirana.

15 janari 2024 është një tjetër datë e shënuar për vlerësimin e xhubletës tonë legjendare, kësaj vlere tashmë ndërkombëtare,

Tirana

*Trashëgimia kulturore jomateriale si levë zhvillimi, në kontekstin "Kultura dhe Kreativiteti për Ballkanin Perëndimor" përfaqësuese e UNESCO-s, Costanza Fidelbo.

*Prodhimi historik midis identitetit, valorizimit kulturor dhe zhvillimit industrial: rasti i "tabarros", Chiara Squarcina, Drejtore e Zonës së Aktiviteteve të Muzeut, Fondazione Musei Civici Venezia

*Kufiri që nuk ekziston: kultura, identiteti dhe zhvillimi ekonomik, Luca Paolazzi, Drejtor Shkencor i Fondacionit North East

*Qëndrueshmëria në strategjinë makro-rajonale të Bashkimit Evropian, Lodovico Gherardi, Rajoni Emilia-Romagna dhe Autoriteti Menaxhues Adrion Program

*Zhvillimi i marrëdhënieve makro-rajonale, Annalisa Bisson Drejtoreshë e Marrëdhënieve Ndërkombëtare, Rajoni Veneto.

*Trashëgimia lokale midis historisë dhe simbolizmit: një studim mbi xhubletën, Zef Gjeta, Instituti i Kerkimeve Rurale dhe Universiteti Bujqësor i Tiranës.

*Tradita dhe inovacioni në trashëgiminë jomateriale të UNESCO-s: rasti i Xhubletës, Majlinda Laçaj, eksperte, ish-drejtoreshë e Trashëgimisë së Shqipërisë së Veriut, Themeluese dhe Drejtoreshë e përgjithshme AlbSmartFolk Global Albanians.

*Trashëgimia jomateriale e UNESCO-s si një forcë lëvizëse për zhvillimin e qëndrueshëm: rasti i Xhubletës, Alkida Hasaj, Universiteti i Shkodrës

Një "det profesionesh". Shënime për një bashkëpunim ndërkombëtar mbi inovacionin dhe qëndrueshmërinë e prodhimit tradicional, Almarin Ndreca, Instituti i Kerkimeve Rurale.

Workshopi shfaqti shumë interes tek të gjithë të ftuarit, drejtues institucionesh në nivel ndërkombëtar. Finalizimi i aktivitetit në Venecia nxori në pah rëndësinë e rikrijimit të lidhjeve të përbashkëta mes dy shteteve Shqipëri-Itali (Shkodër-Venecia) si dy vende që kanë pasur lidhje shekullore tregtare-kulturore dhe një qasje të re ndaj krijimtarisë dhe diversitetit kulturor.

Referentët në këtë workshop theksuan se trashëgimia kulturore duhet të ruhet dhe promovohet ashtu siç e kanë përcjellë komunitetet, por edhe integrimi inovativ është shumë i nevojshëm pa dëmtuar traditën, artizanatin dhe mësimin në funksion të një të qëndrueshmërie socio-ekonomike dhe zhvillimit kulturor.

Tashmë trashëgimia jonë "flet" shqip në arealin ndërkombëtar.

Përgatiti, Majlinda Laçaj

Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, figurë e ndritur e historisë kombëtare

Në kuadër të 556 vjetorit të vdekjes së Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, shkolla 9-vjeçare "Gjergj Kastrioti", në qytetin e Lezhës, me drejtoreshën e palodhur, znj. Dije Zefi, ka përkujtuar me një veprimtari të larmishëm letrarokulturor 556 vjetorin e vdekjes së Heroit tonë kombëtar Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, me nxënësit e kësaj shkolle dhe mësuesit e tyre, një shkollë që mban me nder e krenari emrin e këtij Heroi, me rezultate e cilësi në arsim.

Veprimtari e bukur dhe i larmishëm, në të cilën nxënësit interpretues ishin veshur edhe me kostume kombëtare të përgatitur nga mësuesit e kësaj shkolle, me iniciimin dhe mbështetjen si kurdoherë të drejtores së kësaj shkolle znj. Dije Zefi, duke evokuar jetën dhe veprën e ndritur dhe të pavdekshme të Heroit tonë kombëtar dhe për të mbajtur me nder e krenari emrin e tij, me ecuri në procesin mësimor-edukativ, rezultate të larta dhe cilësi në arsim. Mësuesja e apasionuar e Historisë në këtë shkollë, Arlinda Nikolli ka zhvilluar biseda me nxënësit sipas klasave të shoqëruara me video-projektor në lartësimin e



figurës së ndritur të Gjergj Kastriotit dhe mbi jetën dhe veprën madhore të Heroit tonë Kombëtar, si burim frymëzimi e krenarie, faqe e ndritur e historisë sonë kombëtare, atdhetarie e lirie për brezat.

Me vdekjen e Gjergj Kastrioti-Skënderbeut, më 17 janar 1468, shqiptarëve u mungoi një nga personalitetet më të shquara të historisë kombëtare.

Megjithatë, rezistenca e shqiptarëve vazhdoi me të njëjtën këmbëngulje. Lufta me sukses kundër turqve, i ndihmoi fisnikët shqiptarë të integroheshin në një shtet të përbashkët nën udhëheqjen e Skënderbeut, më 2 Mars 1444. Përvoja e luftërave të shqiptarëve, kishte dëshmuar se Perandorisë Osmane nuk mund t'i bëhej ballë pa bashkimin e forcave të brendshme poli-

tike, ushtarake dhe ekonomike, dhe në të njëjtën kohë kërkohej bashkëpunimi me vendet e tjera, që ishin në luftë me turqit. Si hap të parë të rëndësishëm në këtë drejtim, Skënderbeu gjykoj mbajtjen e një Kuvendi të përgjithshëm, ku do të përfaqësoheshin të gjithë zotërit feudalë shqiptarë. Ato u grumbulluan në qytetin e Lezhës, në Katedralen e Shën Nikollit, ku Kuvendi i Lezhës u mbledh më 2 Mars 1444, i cili vendosi që bashkimi i shqiptarëve të bëhej në formën e një Besëlidhjeje politike ndërmjet drejtuesve të zotërimeve të lira, që u quajt Besëlidhja Shqiptare e Lezhës, kryetar i secilës u zgjodh Gjergj Kastrioti-Skënderbeu, u krijua ushtria e përbashkët me komandant Skënderbeun dhe arka e përbashkët.

Gjergj Kastrioti - Skënderbeu, vdiq më 17 janar 1468 në Lezhë, në moshën 63 vjeçare dhe u varros i mbuluar me lavdi në kishën e Shën -Kollit në Lezhë (Katedralja e Shën -Nikollit), sot Memoriali i Skënderbeut në Lezhë.

Jak Rrozhani gazetar, publicist

Poeti matjan emigrantë në Londër, Xhavit Gasa njeriu i dijes dhe penës shqipe

(Për poetin matjan, që mbjell me vargun e tij shqiptarizmin në Londër)

FJALË ZEMRE!

Prej vitesh e kam përpirë me një etje të pashuar poezinë e Xhavit Gasës, që është më matjan se matjanët kur kërkon që të ngrejë Urë kulturore dhe shkronjore mes Matit të tij të dashur dhe bashkësisë shqiptar të Anglisë kryesisht atij të Londrës.

Pasioni për fjalën e shkruar të Xhavit bashkohet me ata ngjizje të fortë të shqiptarizmit. Ai i do të gjithë stinët matjane. I ka shijuar me gjithë dashurinë që ka si njeri, si poet, si bir, si baba, si gjysh e poe-

zia e tij ika të gjithë këto portrete. Poezia e tij të bën të krenohesh jo vetëm me atë vetë, po dhe me fëmijët që dinë të këndojnë shqip, të shkruajnë shqip. Dhe nuk është më ai Xhavit i Burgajetit i Zenishtit ditëve të para të kurbetit, po ashtu më i pjekur si autor.

Librat e botuar ajo jetë aktive që ai bën krah të gjithë shqiptarëve të Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe e bën poezinë e tij një

Misionar modern të kombit, për të

cilën ne kemi nevojë kaq shumë. Poezia e tij ka pak nostalgji. Thinjat që ia merr era mbi Tamizë i kujtoj jetën e vështirë, po dhe atë që ai ka dhënë me jo pak sakrificë. Mund të shijonte Anglinë edhe me kafet e shumta që janë dhe traditë shqiptare. Mund të ecte me hap të ngadalhtë në parqet natyrore. Mund të ndërronte vizitat në Muzetë e shumë që ka atje po ai e do poezinë dhe me modesti e bën atë, që mund të bëjë më mirë.

Të mbjellë në shpirtrat e fëmijëve e

prindërve shqiptarë gëzimin e shkronjës shqipe madje mjaft poezi të tij mund të jenë pjesë e librave shkollore të mësohen dhe të recitohen në shkollat shqipe apo të bëhen këngë. Ai tani njeh kulturën angleze që dikur ka qenë dhe pjesë e kulturës shqiptare Urimi i zemrës është mirënjohja më e madhe që e meriton ai në çdo kohë.

Nga shkrimtari i njohur nga Çamëria, zoti Namik Selmani



FESTIVALI BURIMOR "TREVA" 2024

Është bërë traditë prej dy dekadash që grupi artistik "Treva" të organizojë festivalin burimor me krijimet më të mira të vitit, shfaqje, të cilat janë organizuar kryesisht në tempullin e artit e kulturës, në teatrin "Migjeni". Edhe këtë vit, në bashkëpunim me bashkinë Shkodër e drejtorine e teatrit "Migjeni", grupi artistik "Treva" organizoj festivalin "Burimor -Treva 2024", që në kete vit ishte dhe 20 vjetori i këtij festivali.

Grupi muzikor "Treva" erdhi në 20 vjetorin e nates tradicionale më i këndshëm se asnjëherë, duke përcjellë folklorin, vlerat dhe autoktoninë e Dukagjinit në këngë, melodi, në varg, në veshje dhe në valle, duke sjellë në skenë më të mirët e folklorit të Veriut, duke promovuar krijimet e interpretimet e tyre më të mira burimore, duke e kthyer këtë natë në një manifestim të madh kulturor e artistik, duke e pasuruar trashigiminë kulturore e folklorike të Dukagjinit e të Veriut.

Kjo veprimtari fillon me vallen e knduar "E n'kta burra ka thanë Leka", e sjellë në mënyrë brilante nga koreografi i mirënjohur Aldo Nika, me ide në tekst e muzikë nga kantautori i mirënjohur Fran Kodra, kënduar nga grupi i burrave.

Lahuta është instrumenti më i vjetër në Dukagjin e më gjërë, bashkëdhëtare ndër breza që ka shoqëruar ndër shekuj qëndresën, trimërinë e traditën, e cila nuk mungoj as në këtë veprimtari folklorik. Emigranti shaljan, Agim Shytani, me zërin e tij karakteristik, melodioz e të kthjellët si ujët e burimeve të vendlindjes, u paraqit me lahutë, me këngën "Moj Shqipni kush t' ka dhanë emër", e cila u pëlqye shumë nga spektatori.

Këngëtari tashmë i afirmuar nga Toplana, Prël Rushaj interpretoj këngën "I zoti i i shtepisë t' u rrit ndera", i cili në vijim të programit u paraqit edhe me këngën "Festat e Dukagjinit", duke rrjesh-tuar festat fetare me miqtë nëntë krahinave të Dukagjinit, të cilat në fillim kanë pas qëllim njohjen, bashkimi dhe komunikimin, por që vitet e fundit është venit shumë ky rit fetar, i cili ka tendencë me u kthye në festa familjare.

Këngëtari i talentuar nga Shoshi, Kolë Arramadhi interpretoj mjaft mirë këngën "Djelmnia".

Ishte shumë pozitive bashkëpunimi i grupit "Treva", me grupin artistik të shoqarës "Besa e Shoshit", i cili vitet e fundit ka pasë një veprimtari të dëndur, duke promovuar shumë vlera të traditës për Dukagjinin e më gjërë. Ky grup u paraqit në këtë natë me tre këngë "A kapelo", "Lidhi Shala besën", në të cilën althernohen vargje për heroizmin e shtatë shaljanëve me Marash Tucin e Shoshit, si dhe këngën "Dukagjini më i shtrejtji emër", këngë të cilat u interpretuan shumë cilësisht nga grupi i burrave dhe u pëlqyen shumë nga publiku.

Është shumë pozitive kur kaq shumë artista dukagjinas promovojnë vlera tradicionale folklorike, duke i pasuruar ato e duke i mbajtur gjallë në shpirtin e tyre artistik.

Instrumentisti e këngëtari Sokol Gjoni

erdhi me këngën "Kur i këndojmë folklorit".

Ky festival për çdo vit ka zbuluar dhe ju ka dhënë hapsirë shumë talenteve të reja në fushen e folkut, të cilët me zërat e tyre karakteristik kanë sjellë risi në festivalin burimor.

Këngëtarja nga Tropoja, Mirjeta Çelaj kishte zgjedh një këngë lirike bjeshke, e cila u pëlqye nga të pranishmit.



Këngëtarët e rinj shumë të talentuar Novi Prendi e Noel Pjetri sollën një këngë për figurën e madhe të Dukagjinit -Dodë

fort. Këngëtari tashmë i afirmuar, Bardhok Luca, është bërë shumë i pëlqyer për



Tahirin. Mirë do të ishte që me lanë më tepër hapësirë Dodë Tahirit, nje nga personalitetet e futbollit shqiptar.

Si gjithnjë, as kësaj rradhe nuk mungoj humori i hollë i grupit "Gaz e Maraz", të cilët e elektrizuan sallën.

Grupi "Treva" gjithnjë ka bashkëpunuar me këngëtar të njohur jodukagjinas. Treshja e mirënjohur Elvira Fierza, Fran Kodra e Ndue Shytani interpretuan me shumë profesionalizëm këngën "Si e don këngën me ta knu", e cila u pëlqye shumë.

Kishte udhëtuar nga larg për t'u bërë pjesë e grupit "Treva", këngëtarja Luiza

Reka, e cila u paraqit me këngën "Pse ke mbet pa dashuri".

Këngëtarët e rinj i dhanë gjallëri kësaj veprimtari, me entuziazmin e tyre. Të tillë ishin edhe Gentian Gropa me një balad "për nënën" dhe Bledar Hisenaj me një këngë lirike bjeshke "Qan syzeza".

Një këngëtar i njohur në dasma e gëzime, Rexhio Ograja erdhi me këngën "Luje vallen Dukagjin", e cila u duartrokoi

natë të madhe të folkut, me prezencën e tij dhe interpretoj me zërin e tij melodioz e të kthjellët si uji i burimit të Currajve të Epërm, këngë për "Shote Galicën".

Parodisti gazmor, Gegë Shpati u paraqit me një parodi, i cili me shumë humor vinte përballë kohën e sotme me plagët dhe të këqijat e saj në antipod me kohën e Enverit. Pati shumë ilaritet në publik.

Shkodra ka lind shumë heronj, të cilët në periudhën moniste mbetën në hije e nuk u përmendën, sepse ishin viktimat të vetë regjimit të tillë, ishte edhe bija e Dukagjinit, nga fshati Palaj i krahines së Shllakut, Marije Shllaku, e cila bashkë me Kolë Parubin, At Bernadin Llupin e Gjergj Martinin u vranë në burgun famkeq të Prizrenit dhe mbetën pa varre. Këngëtari i mirë njohur nga Prizreni, Nikollë Gjini u paraqit me këngën "Motra me tre vlezër", e cila u mirëprit nga publiku.

Emigrantët janë frymëmarrje për kombin, që kontribojnë për vendlindjen, por kënga e kënduar nga Mirjeta Çelaj, është një apel për ata që harrojnë me titull "Si na harrove" e shoqëruar nga grupi. Një këngë të ngarkuar me mallë për vendlindjen e solli me emocion Agim Shytani, me titull "Si erdhi jeta". Shkodra gjatë gjithë historisë ka qënë pjesëmarrëse aktive në të gjitha ngjarjet kulmore, duke pas edhe heronjet e saj, që mbi të tjerët qëndron Luigj Gurakuqi. Këngëtari me shumë të ardhme, me një mjeshtëri interpretuese, Novi Prendi solli këngë për "Luigj Gurakuqin".

U prit me ovacione këngëtari i afirmuar dhe shumë i kërkuar, Gjovalin Shani, pjesë marrës i përhershëm e kësaj veprimtari, i cili këndoj këngën "Burrat e Dukagjinit", në të behet fjalë për tre dukagjinas emërmëdhenj: Mark Lula nga Shala, Marash Kola nga Shoshi dhe Gjekë Gega nga Shllaku, të cilët ishin pjesëmarrës në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit.

Rreth rolit të femrës në familje dhe dinitetin e saj bashkë me burrin në konsolidimin e familjes bënte fjalë kënga "S' ke pa gjë akoma", interpretuar nga Shytani, Kodra, Fierza e Luiza Reka.

I mirënjohuri Roland Qukaj kësaj radhe u paraqit, me këngë për fukananë, me një version tjetër nga ai i pari.

Qershia mbi tortë ishte i përhershmi, këngëtari i talentuar Zef Beka, i cili interpretoj siç din Ai, këngën për shaljanët, që sipërherë e bëri publikun për vete.

Kjo veprimtari artistike-folklorike mbresëlënëse u mbyll me këngën "E n'kta burra ka thanë Leka" interpretuar nga grupi.

Të gjitha këngët u shoqëruan nga grupi i valleve i përgatitur nga koreografi i talentuar Aldo Nika dhe pjesa më e madhe e këngëve ishin krijime të reja, me tekst e muzikë nga kantautori i mirënjohur Fran Kodra.

Moderatore e kësaj nate tradicionale ishte adoleshentja hotjane, e bija e instrumentistit të talentuar dhe mësimitshëm Eduart Leka, mbesë Dukagjinit-Helena Leka, e cila e prezantoi me

Shoshi kujton e këndon

Me 28 dhjetor 2023, ditën e Enjte, ora dhjetë paradite Shoqëroja Kulturore Artistike "BESA-Shoshi" organizoj në kompleksin "Rinia", në Bardhaj veprimtarinë e dytë, me teme: "Shoshi kujton dhe këndon – 2024".

Kjo veprimtari organizohet për here të dytë dhe kjo u kushtohet të treturve të Shoshit në Kerr Torobullus, në Turqi, në

të kaluam dhe u lexues emën për emën dhe kush janë më të afërmit e tyre në Shosh. Ky libret kishte zbulime historike për Shoshin, poezi kushtuar të treturve në Turqi dhe figurave të tjera të lavdishme nga Shoshi. Ndërsa programi muzikor ishte i gërshetuar me kënge lirike, epike historike dhe patriotike.

Fillimi ishte me ritet e dasmës në Du-

e Njësive lokale administrative të Dukagjinit dhe drejtues të pushtetit lokal Shkodër dhe Rrethina. Gjithashtu edhe shoqëri kulturore, artistike e atdhetare të ndryshme si motra.

I falënderojmë për pjesëmarrjen në këtë manifestim kulturor!

Në mënyrë të veçantë falënderomë me shumë respekt, kryetarin e shoqatës "Bytyçi", Tirane-Prizren, me qendër në Tiranë z. Agron Isa Gjedija, i cili mori pjesë dhe përshëndeti në emër të shoqatës, duke dhanë falënderimet për këtë veprimtari, si dhe dhuroj një tirash të gazetës "Bytyçi" periodik i kësaj shoqërie, që ne e falënderojmë përzemësisht. Ishin të ftuar nga Shoqata Atdhetar "Dukagjini" Roza Pjetri, Kolë Çardaku, Gjon Shtegu e të tjerë.

Gjithashtu në mënyrë të veçantë falënderojmë Bona Mula-Llukaj, poete ardhur nga Lezha, e cila falënderoj dhe demonstroi një poezi të saj me shumë vlera në program.

Gjithashtu falënderojmë dhe këngëtarin Novi Prendi ardhur nga Puka, i cili interpretoj bashkë me këngëtarin e ri Noel Pjetri një kënge epike. Për të na nderua kishin ardhur edhe këngëtarët Bardhok Luca, Gentjan Gropa e Bledar Hysenaj, që e kompletuan programin tone.

Por qershia mbi tortë ishin valltaret e shkollës 9-vjeçare "Dede Gjon Luli" në Hot të Ri, me mësueset e tyre Drita Zefi dhe N/drejtoreshën e shkollës. Zj. Tule Ahi, që i dhanë vlera manifestimit tone.

Gjithashtu falënderojmë Leonora Milanin, aktore shumë e spikatur, që luajti rrolin e nuses tek "Dasma e Dukagjinit" si dhe kostomografen File Kolja, e cila u kujdes për veshjen kombëtare.

Në mënyrë të veçantë duhet përgëzuar dy konferencieret, Linda Doda dhe Anila Milani, të cilat i dhanë shkëlqim këtij manifestimi, me poezitë që interpretuan dhe me prezantimin e përkryer të pro-

gramit.

Nuk duhet harrua aktoret e rinj, të cilët kënduan dhe recituan, në mes tyre këngëtarin i vogël nga Vuksanaj Shale, me banim në Tiranë, i cili këndoj dhe dy aktoret e reja, Ema Fusha dhe Nora Koçeku nga Shoshi, që recituan pjesë poetike nga programi jonë.

Në këtë manifestim folën dhe falënderuan personalitete të ndryshme si z. Ilmi Kurti, kryetar i Shoqatës Atdhetare "Malësia";

Lulash Brigja, udhëheqës artistik i "Sofrës së Dukagjini";

Dedë Shullani kryetar i shoqatës të pajtimit të gjaqeve;

Pal Deda nga Shoshi simpatizant;

Ndoc Ashta ish kryetar komunë në Shosh; Mimoza Rexhvelaj poete; Kolë Çardaku N/Kryetari i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini".

Respekt të veçantë dhe falënderime për gjithë pjesëmarrësit e këtij manifestimi, të cilët na nderuan.

Për temat, që u manifestuan në këtë manifestim, duhet një pllakat, një lapidar, një gurë memorial apo diçka të ngjashme për të përjetësuar historinë e lavdishme të kësaj krahine nder shekuj, por me gjithë kërkesat tone nuk kemi gjetur mbështetje. Këtë kërkesë e kemi bërë edhe dje e bëjmë edhe sot do e bëjmë edhe nesër pa pasur parasysh ngjyrat politike, sepse jemi shoqëri jo politike, jemi më shumë humane, kulturore dhe artistike.

Falënderoj pjesëtarët e grupit tone, që kontribuuan materialisht dhe artistikisht në realizimin e këtij manifestimi, në veçanti kryetarin tone, z. Ndoc Fusha, që pati ngarkesën kryesore të kësaj veprimtarie, gjithashtu edhe kontribuuesit financiar, pa të cilin kjo veprimtari nuk do të përgatitej e zhvillohej!

Në fund, një falënderim i veçantë për punën e palodhur të kameramanit Artur Pasko, me djalin e tij dhe që bënë një punë të mrekullueshme duke e filmuar manifestimin.

Ne, nuk jemi më të mirët, por besoj se çdo gjë e bëjmë me shpirt e me pasion dhe e kemi një ndjenje fisnikërie për ruajtjen e vlerave tona kombëtare.

Dëshirojmë të jemi prapë bashkë, në veprimtari të tjera artistike e kulturore!

Ky manifestim gjendet i regjistruar në kanal tonë "Besa Shosh"- Shoqëri Kulturore, në JUTUB.

Gjon Dedë Kosteri, Bardhaj,
Shkodër, me 28 Dhjetor 2024



vitin 1870, që u tretën 24 djem dhe kreun e Shoshit, prej të cilëve një pjesë nuk u kthyen kurrë ma gjallë!

Libreti i përgatitur nga Prel Milani, historian, poet, publicist dhe shkrimtar. Libreti ishte i kompletuar historikisht, artistikisht, me histori të vërteta thane nga bashkëkohës të të treturve dhe shkrua nga famullitari i Shoshit në fillim të shekullit

kagjin, që u interpretua nga grupi "Besa Shosh", me nivel shumë të lartë artistike e tradicionalë me të gjithë elementet e një dasme në Dukagjin. Pastaj programi vijoi me folklor të moderuar dhe tradicional.

Me këngëtar të ftuar nga Dukagjini, Puka si dhe këngëtarët e grupit "Besa-Shosh" ishin të ftuar dhe personalitete të artit e kulturës në Shkodër, kryetaret

zhvillohen në Europë dhe Amerikë. në këtë kuadër dha edhe disa tituj nderi, në emër të institucionit që drejton "Ansambli Treva", me titullin "Princ i Artit tradicional të Dukagjinit". Ju dha tituli nderi, këngëtares Elvira Fierza, me titullin "Prince e Artit tradicional të Dukagjinit", kurse Prelë Marku (pas vdekjes), ju dha tituli "Mjeshtër i Folklorit Shqiptar".

Kjo veprimtari kaq mbresëlënëse nuk mund të zhvillohej pa ndihmën e bashkisë Shkodër dhe grupit të teatrit "Migjeni" si dhe pa kontributine dukagjinase kudo që janë si: dukagjinasi në New - York- Kujtim FuniçI, Ndoc Suka, Vatë e Ilir Biga, Ndrej Tona, Vladimir Lpeja e Tonin Mbrapshtija, si dhe Xhovani, bar

restorant "Floga", klinika dentare "Bobnaj", biznesmeni Gjin Mani, Pavlin Polia, Gjon Shpella, Martin Cubi, bar-restorant "Orlando", Ejll Radohina, Gjergj Ejlli, të cilët i faalenderojme dhe u urojme me shprehjen popullore "Paçi e dhënçi!"

Bukuri këtij aktiviteti i dha studio "Valbona", e cila në monitor paraqiti gjatë gjithë kohës pamjet madhështore të alpeve tona, pjesë e Dukagjinit.

Stacioni televiziv TV -Kopliku filmoj dhe transmetoj të plotë këtë veprimtari në një ndërnet të ndërrimit të viteve.

Organizimi ishte i përsosur në sajë të atyre që e organizojnë këtë veprimtari artistike: drejtuesi muzikor – Luan Dakistani, regjia e koreografia Aldo Nika,

udhëheqës organizativ Ndue Shytani dhe producent Fran Kodra.

Festivali burimor mbetet një manifestim i madh tradicional jovetëm për Dukagjinin, por për krejt Veriun Shqiptar dhe kudo ku ka shqiptar, një pasurim i trashigimisë kulturore dhe bënë një apel, që kjo trashigimi të transmetohet në breza ku grupi "Treva" po jep shembullin.

Ansambli "Treva" i urojmë arritje më të mëdha në të ardhmen!

PRELË SHYTANI,
SHKODË R - JANAR 2024

shumë kometencë veprimtarinë, larg frazologjive të tepërta, siç ndodh me shumë prezantues, por duke i qëndruar strikt skenarit.

Si shumë herë të tjera edhe kësaj rradhe e përshëndeti festivalin Minella Kureta-Mjeshtëri i madh, Drejtor i përgjithshëm i Qendrës së Artit e Kulturës Shqiptare, i cili pasi vlerësoj shumë grupin "Treva" e në veçanti ata që i kanë mbajtur gjallë grupin e veprimtaritë e tij si poet, instrumentist, interpretues e organizator të talentuar Fran Kodra e Ndue Shytani, veprimtaria e të cilëve është ndërkom-bëtarizuar, sepse kontributi i tyre është i madh jo vetëm si interpretues, por edhe si organizator i shumë veprimtarive, që

NATA E BASHKIMIT

TAKIM TRADICIONAL I SHOQATËS "DUKAGJINI" NË MICHIGAN

Mbrëmja festive e "Natës së Bashkimit" të shqiptarëve, e organizuar nga Shoqata "Dukagjini" në Michigan, është kthyer tashmë në një festë tradicionale jo vetëm për dukagjinast, anëtarë apo mbështetës të kësaj shoqate, por edhe për mbarë kombashkësine shqiptaro - amerikan në Michigan të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Për 18-vite me rradhë, që nga data e themelimit të kësaj shoqate, në vitin 2005, është bërë traditë që të organizohet "Nata e Bashkimit" apo e takimit, siç e prezantojnë zyrtarisht drejtuesit e shoqatës, e cila gjithnjë e më shumë po dëshmon për rëndësinë dhe vlerat që mbart kjo darkë solemne.

E menduar si një nevojë për të përbushur objektivat dhe qëllimin, për të cilin është themeluar kjo shoqatë, duke u pasuruar gjithnjë e më shumë ndër vite me vlera kulturore e humane, traditë dhe folklor, shpesh edhe për të mbledhur fonde për t'i dhënë një dorë mbështetje vëndlindjes, ky bashkim i ka kapërcyer të gjitha limitet për t'u quajtur vetëm një darkë rutinë e takimit të shoqatës, ndaj me të drejt sot në bashkësi njihet "Darka e Bashkimit të Shqiptarëve".

Ky bashkim e hapi siparin e tij në orën 19.00 të mbrëmjes së 29-dhjetorit, në sallën e Kishës "Zoja Pajtores", e cila prej dekadash është kthyer në strehë shpirtërore dhe vllazërore për gjithë shqiptarët. Fjala e rastit dhe e mikpritjes, ashtu siç ka qenë traditë atje, në kullat e gurit në Malësinë e Dukagjinit, e mbajti i zoti i shtëpisë, z. Ndue Ftoni, Kryetar i Shoqatës "Dukagjini" në Michigan, i cili ndër të tjera tha:

"Sonte, këtë darkë do ta quaj darkë bashkimi e falenderimi, pasi sonte në këtë sallë jemi bashkue dukagjinast, malësorë, patriotë shqiptarë dhe intelektualë të shquar, drejtues shoqatash dhe ansamblesh, që punojnë e kontribuojnë me devocion për çështjen kombëtare.

Në këtë darkë dua të falenderoj të gjithë ata dukagjinast e jo vetëm, që punuan e kontribuan në vite për të mbajtur të gjallë frymën e bashkimit në këtë shoqatë, që ndihmuan e kontribuan në mbledhje fondesh për donacione, duke investuar në art, në kulturë, në infrastrukturë e në nevoja jetike në Dukagjin, Shkodër e këtu në bashkësi Shqiptar të Michiganit.

Gjithashtu dua të falenderoj të gjithë ata dukagjinast, që më kanë mbështet edhe mua si kryetar i shoqatës, në mbarvajtjen e punës organizative".

Me shumë dashamirësi, z. Ndue Ftoni falenderoi me përzemërsi të ftuarit dhe miqtë e ardhur nga larg, si dhe të gjithë të pranishmit, duke i cilësuar dhe vlerësuar për punën dhe kontributet e tyre në veprimtaritë dhe fushat e tyre të jetës.

Në organizimin e Darkës së "Bashkimit" nga Shoqata "Dukagjini" në Michigan, një rol të rëndësishëm në mbarvajtjen e saj, pati edhe performanca e moderatores të njohur nga Mirdita, studiuesit dhe akademikut Zef Pergega, i cili me shumë seriozitet dhe profesionalizëm, përcolli emocion dhe dinjitet tek të pranishmit.



Me një prezencë sa zyrtare, aq miqsore, përshëndeti të pranishmit edhe Av. Ervin Tinaj, Kryetar i Shoqatës "Kelmendi", i cili si më i riu ndër këta drejtues, me fjalë të

mirëpeshuara në mençurinë e malësorit, falenderoi organizatorët dhe përshëndeti të pranishmit me fjalë zemre.

Në takimin festiv të Shoqatës "Dukagji-

ni" në Michigan, ishte i ftuar bashkë me Shoqërinë Kulturore - Artistike "RAP-SHA NË MËRGIM", z. Anton Junçaj, i cili në fjalën e tij përshëndetëse përcolli emocione të veçanta tek të gjithë të pranishmit.

Prezantimi i performancës së shkëlqyer i valltarëve dhe përshëndetja e tij, i dhanë nuanca patriotike dhe atdhetarie kësaj darke bashkimi, për çka vlerësohet nga i gjithë bashkësia si një malësor i traditës dhe i mikpritjes.

Në këtë darkë bashkimi u përkujtua edhe këngëtari dukagjinast Prelë Marku, i cili me këngën dhe zërin e tij, transmetoi në bashkësi, folkun burimor të zones, duke marrë pjesë dhe duke e shpalosur atë në koncerte e veprimtari kulturore të Diasporës Panshqiptare.

Televizioni ACTV në Michigan transmetoi përmes një projektori një insert që tregoi vlerat e këtij këngëtari të paharruar.

Të ftuar në këtë mbrëmje bashkimi ishin edhe këngëtarët e mirënjohur të trevës së Dukagjinit, rapsodët Fran Kodra dhe Ndue Shtyani.

Qendra e Artit dhe Kulturës Shqiptare me president Dr. Minella Kureta, e nderoi këngëtarin e paharruar Prelë Marku, me titullin "Mirënjohje", të cilën në emër të kësaj qendre e dorëzoi artisti Fran Kodra.

Viti 2023 ishte shpallur edhe Viti i Xhubletës, si një vlerë e çmuar, e cila u pranua në UNESCO.

Shoqata Kulturore "Xhubleta e Alpeve Shqiptare" e nderoi z. Ndue Ftoni me titullin "Mirënjohje", në vlerësim të punës dhe kontributit të tij, si një veprimtar i shquar për merita të jashtëzakonshme, jo vetëm në treven e Dukagjinit dhe të Malësisë së Madhe, ku ruhet e trashëgohet xhubleta, kjo pasuri materiale dhe shpirtërore e lokeve tona, në prehërin e së cilës është rritur edhe z. Ndue Ftoni, por edhe për ruajtjen e kësaj trashëgëmie, në bashkësi e Shqiptarëve në Amerikë, si atdhetar e veprimtar, por dhe si përfaqësues i Shoqatës "Dukagjini" në mërgim".

Darka e Bashkimit shpalosi edhe një herë vlerat kulturore të Dukagjinit, të gërshtuara me këngë e valle tradicionale, si dhe vlerësime kontributesh për antarët dhe aktivistët patriotë shqiptarë.

**Nga Ramazan Çeka,
Miçigan, Dhjetor 2023**



Sofra e Dukagjinit 2024

Me datën 30 Dhjetor 2023, në ambientet e Bar Restorant "Antika" veprimtaria, me titull "Sofra e Dukagjinit-2023".

Për të 7-tin vit radhazi kjo festë është kthyer traditë në një ngjarje nga më të rëndësishëm të muzikës folklorike tradicionale të Dukagjinit dhe më gjerë. Nen kujdesin e presidentit të saj Shoqata "Sofra e Dukagjinit", z. Vuksan Xhuri, nën kujdesin artistik të dhe tekstshkruesit z. Lulash Brigja dhe drejtuesit organizativ, z. Marjan Ndërshtiqaj, të cilët kujdesen që gjithmonë të sjellin më të mirën për publikun. Ashtu siç u premtua nga organizatorët edhe këtë vit "Sofra e Dukagjinit" fillimisht u mbajt në Londër, me 2 dhjetor 2023.

Një nga sfidat më të mëdha që është ruajtja e autentikes dhe përshtatja me modernen duke emancipuar secilin nga brezat, "Sofra e Dukagjinit" ia ka arritur më së miri.

Janë disa elemente, që janë thelbësore, që e bëjnë këtë "sofër" të suksesshme që nga viti 2017 dhe në vijim:

*Fillimisht janë këngëtarët, që gjithmonë janë të pranishëm ato e ata që kanë ndërtuar histori në muzikën tradicionale, janë ikona që do njihen për breza të tërë si Gofile Papekaj, Gjovalin Shani, Ndue Shytani, Fran Kodra, Nikolin Përpali, Bardhok Perbibaj, Preke Mrishaj, Ndoc Fusha, Gege Zefi, Bardhok Lucaj, Kole Hasani, Petrit Gjinaj, Gjesh Fusha, Kole Aramadhi, Bardhok Mehmeti e të tjerë.

Pastaj një nga veçoritë që ka kjo "Sofër", është promovimi i artisteve të rinj të muzikës tradicionale, të cilët janë gjithmonë të lumtur dhe krenare të përfaqësojnë Dukagjinin, por edhe zonën nga të cilën vijnë, si Nora Ndreu, Gentjan Gropaj, Bledar Hysenaj, Zef Nika, Kristaj Zalli, Noel Pjetri, vëllezërit Marsid dhe Mirsad Biga si dhe Aurela Moshqej.

**Sofra" gjithashtu përfshin edhe femijet si ajkën e shfaqjes, që me vallet e tyre kërcëjnë si flutura në skenë, energjia e tyre ka shoqëruar çdo këngë dhe çdo valle në atë skenë, që janë grupi i valleve të shkollës 9-vjeçare "Dede Gjo Luli", Hot i Ri Shkodër,

*Por, "Sofra" nuk harron kurrë edhe miqtë, artiste nga Kosova, të cilët gjithmonë na mirëpresin kur e vizitojmë familjet e tyre si të jemi në shtëpinë tonë dhe këtë vit risia ishte këngëtarë Martin Gojani.

Elemente thelbësore gjatë shfaqjes janë: Falënderimet për mundësitë financiar, që bëjnë të mundur shfaqjen, të cilët

çdo vit janë bujare, për tu siguruar që shfaqjes të mos i mungojë asgjë, meritonjë mirënjohje të madhe si nga diaspora, por edhe bizneset vendase, si:

I gjithë veprimtaria u prezantua nga prezantueset, Klodjana Seraj, e cila kishte edhe jubile këtë vit, duke mbushur plot 5 vite që prezanton "Sofrën" dhe Pamela Mirashi, e cila rikthehet për të dytin vit.

Vlera me e madhe e çdo viti, është edhe arsyeja, pse behët kjo shfaqje, Publiku. Atij, publiku që e adhuron "Sofrën", atij publiku, i cili rezervon që në muajin

Gusht vendin në "Sofër"; të atij publiku që vjen posaçërisht nga diaspora për "Sofrën e Dukagjinit"; të atij publiku i cili dëshiron, që tradita të përcillet dhe të atij publiku që kontribuon që "Sofra" të transmetohet. Prandaj mund të themi se "Sofra e Dukagjinit", i bën nder Dukagjinit me prezencën e saj, ka emrin e madh, dhe duhet të jetë gjithmonë e pranishme në çdo ne ditët dhe festat e të gjithë Dukagjinasve kudo që ndodhen, por edhe të gjithë Shqiptarëve.

Klodjana Serraj



Lamtumirë Fran Zefi!

Këto dite, në spitalin "Universitar Erasme", në Bruksel ka ndërruar jete Fran Zef Marku, i datëlindjes 5 maj 1940, në moshën 83 vjeçare. Fati e deshi që festat e fund vitit, ti kalonte tek vajza e tij në Bruksel, por një atak kardiak e ka goditur. Pavarësisht shpejtësisë së ndihmës së pare dhe intensive për disa dite, ai nuk mundi t'i shpëtoje vdekjes. Fran Zefi ishte i biri Zef Bales, nga fshati Nenmavriq, i krahinës së Shalës, i cili vinte nga një familje me taban shumë të mirë tradicionalisht.

Frani ishte një burrë i urte e i mençur, një burrë zotëri. Një njeri i mbajtur, që asnjëherë nuk e tregonte moshën. Dallohej për gjuhën e ëmbël me të gjithë, që dhe përfshihej në pajtimet e konflikteve apo

mosmarrëveshjeve.

Fran Zef Marku do të largohet nga Nenmavriqi, në vitin 1953, për arsye se pusheti popullor i kohës do ta shpallte axhën e tij, Lulash Balen "kulakë" dhe nuk gëzoj kurrë testen e frontit demokratike, duke mos pasur të drejt vote, duke u veçuar për të mos marre pjese në dasma, në morte e mbledhje të fshatit. Kështu, kjo familje e nderuar dhe e njohur për burrëri e bujari, do të largohet për në fshatin Gurrëz, në Laç të Milotit, ndërsa pjesëtarë të tjerë të familjes do të vuajnë internimin në Berat. Edhe pse shumë vite larg nga vendlindja për të larguar nga "lufta e klasave", Frani kthehet përsëri në Shkodër, në vitet e demokracisë dhe jetonte në një apartament komod tek Fusha e Druve, Shkodër.

Frani dallohej për kulturën e tij të gjere. Është një nder familjet e rralla të Dukagjinit që kishte një bibliotekë me mbi 2000 libra. Me një arsim të privuar

nga sistemi komunist për shkaqet biografike, por shumë i dashur me librin e në mënyrë të veçante me librat historike. Ishte pjesëmarrës në festivalet folklorike lokale e kombëtarë. Ishte i përfshirë në librin "Historik i Arsimit dhe Kulturës në Dukagjin", me shkrim e me foto. Ishte një burrë i urte dhe mbështeste vërtetësinë e fakteve historike në lidhje me Dukagjinin. Deri në fund të jetës do të ishte një zë i fuqishëm në pajtimin e gjaqeve.

Na pikëllove me ikjen tende burrë i nderuar e i mençur. Do kujtohem gjithmonë për fjalët tuaja plote shprese. I shprehim ngushëllimet më të sinqerta familjes së tij Arturit, Sandrit, Artës e të gjithë të afërmeve të tij kudo që ndodhen! Ishte njeriu që tregonte se, nuk ka rendësi se sa gjate jetohej, por se sa me dinjitet kalohen vitet e jetës! Ishte njeriu, që vështirësitë e pengesat nuk e përkulen kurrë!

Pushofsh në paqe Fran Zefi !



ORIGJINA E ISA BOLETINIT

Familja Buletini para 14 brezash është larguar nga Penikut e Shalës dhe para 8 brezash ka qenë e besimit katolik.

Isa Buletini personazh magjepsës, i para dhe prag viteve të pavarësimi dukagjinas i madhërishtë nga fshati Isniq i rrethinave të Mitrovicës. Figurë, patriotike karizmatike enciklopedike, plotë dritë, por edhe hije kalimtare, që ka marrë gjitha vlerësimet e mundshme nga historia (në monografi, artikuj, trajtesa shkencore, zëra fjalorësh historik, fjalorësh enciklopedik, zëra të enciklopedisë së përgjithshme), Isa Baletini personazh fort interesat në letërsi e kinematografi (sidomos folklori dhe artet figurative e kanë metaforizuar deri në mistifikim). Si pak figura të tjera, Boletini është vlerësuar pozitivisht në çdo fazë të shtetit shqiptarë. I mjaft kënduar një hartim i bukur shkruar si në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni i quajtur Baca i Pavarësisë, por edhe i stampuar në mënyrë butaforike në pankarta e flamuj nder rrjetet sociale e stadiume si "njëra kokë e shqiponjës" e Shqipërisë Etnike, kostum që nuk i bën mirë dhe nuk do ta pranonte as vetë për së gjalli.


Në lidhje me origjinën e familjes Boltetini zyrtarisht thuhet:

1-Origjina e hershme e familjes së Boletineve prej nga rrjedh i famshmi Isa Boletini, është nga fshati Isniq. Në atë fshat që përpara periudhës së Gjergj Kastriotit, thuhet të ketë banuar i pari i tyre, që quhej Lekë, i cili ka pasur tre djem: Nika, Cana dhe Preka. Nga këta tre vëllezër, që jetuan në fshatin Isniq, rrodhën dhe u krijuan tre lagje, që morën emrat: Niklekaj, Canalekaj dhe Preklekaj, të cilat u shumuan dhe arritën deri në 500 shtëpi. (Paralelizmi me Gjergj Kastriotin, më duket i pa vend, pasi ai nuk kishte as një lidhje me këtë krahinë dukagjinase, por as kjo vjetërsi nuk argumentohet dot, nënvizim PM)

2- Prof. Skënder Luarasi, në monografinë thotë: Se të parët e kësaj familje të detyruar nga depërtimet e pushtuesve osmanë, kanë zbritur nga viset veriore ku banonin në atë kohë dhe janë vendosur në fshatin Boletin aty rreth vitit 1529, ku morën dhe mbiemrin Boletini. Ky fshat, i cili është dhe vendlindja e Isa Boletinit. Në këtë linjë ka sjellë kujtimet e veta edhe studiuesi Elmaz Plava. Studiuesi Gjete Ndoj për disa vite Drejtor i Arkivit të shtetit, në librin e tij "Arkiva shqiptare" ka publikuar kujtimet nipit të Isa Boletinit, për origjinën e familjes.

3-Kujtimet më të plota dhe me afër së vërtetës janë ato të nipit të Isa Boletinit, i cili thotë:- Se para 370 vjet të parët tanë kanë ardhur prej Pecajve të Shalës e shkue në katundin Isniq, pranë kishës së Deçanit. Këtu ka ardhur një i quajtur Leka, me tre djem (Nikë Leka, Prekë Leka dhe Cam Leka). Nga këta tre djem, tre lagje, me emër me të njëjtë emra. Ne jemi nga barku i Nikë Lekës. Isniqi tash përbehet prej më se 150 shtëpi, janë të dalë edhe 100 shpi nëpër Nahijen e Pejës. Nga barku i bacës Pec Lekës rrjedhin (kështu djalë mbas djalit) bijtë e tij

1-Pepa



2-Nika
3-Deda
4-Stako
5-Leka
6-Vuka
7-Leka, te bijtë e tij
8-Muja, Preka, Cama, Dema, Preka e Cam

9-Hajdari-Haliti Ahmeti
10-Murseli, Ademi, Jashari, Nimani, Abdiu, Osmani, Myftari
11-Të bijtë e Ahmetit
12-Tafil, Jonuzi, Haliti.
13-Të bijtë e Ahmetit
14-Isa, Halili, Muja Ademi, Zahidi, Musa Bajaziti, Faiku, Asllani, Kapllani

Rrjedha gjenealogjike e Shalës buron nga ishte një farë Vald Bengu. Ky pati një djalë, që u quajt Pepë Vladi dhe më pas një nip, që u quajt Nika Pepa. Ky Nika pati 4 djem (Peci, Loti, Leka, Deda), prej të cilëve rrjedhin 4 vëllezëritë e mëdha të fisit të Shalës. Nga ballafaqim traditës gojore (kulturë) në Shalë dhe traditës gojore të familjes Boletini, për linjën gjenealogjike, pa kurrë fare ngatërrese arrijmë te a'tlashi i parë i Boletinve Lekë Peci i Pec Nikës - Pepë Vladit- Vlad Bengut (që është atlashi i gjithë Shalës). Pra, familja Isa Boletinit para 14 brezash është larguar nga Pecnikajt e Shalës dhe para 8 brezash ka qenë e besimit katolik.

SHALA KATOLIKE E SHKODRËS AMA E SHALËS SË BAJGORES

Shala e Bajgores apo siç njihet Shala kreshnike është tërësisht i fisit Shalë, përbehet prej 4 vëllezër Peci- Gima- Maleta (Lotaj) e Lopçi.

Johann Georg von Hahn, i cili në vitin 1858 udhëtoi nëpër Kosovë, të cilën ai e quan Dardania Shqiptare, gjithashtu vuri re praninë e njerëzve të Shalës rreth Vushtrrisë në verilindje të Kosovës: "Shala përbejnë popullsinë kryesore të rajonit të Vushtrrisë dhe njohin Shalën katolike të Alpeve Shqiptare si fisin e tyre amë. Këtyre ditëve në Kosovë, Shala janë të përqendruar kryesisht rreth Mitrovicës dhe Trepçës, në rajonin kodrinor i njohur si Shala e Bajgores (Shalës së Bajgores), Ba-

igora ishte vendbanimi më i madh prej 37 vendbanimeve tjera të tyre. Janë të ndarë në katër fise apo Vëllazëri: Gima, Peci, Maleti (të një familje me Lotaj në Shqipëri) dhe Lopça. Gjendet edhe një numër i mire i Shalës në Isniq, Lluka e Epërme dhe Strellci i Ulët afër Deçanit, në Ujmirë në lindje të Klinës, në Kopiliq i Epërm në Drenicë, në Rakosh dhe Citak në Podgor, dhe në disa fshatra të luginës së Lepencit të Epërm. Në të vërtetë, në numër më të vogël ata janë të pranishëm në të gjithë Kosovën. Shumica e tyre ruajtën shumë mirë traditat e identitetit të tyre fisnor.

ISA BOLETINI SIPAS ZBULIMIT TË MARINËS ANGLEZE

Luftoi kundër turqve deri sa këta u shpartalluan, pastaj u bashkua sërish me ta, për të pushtuar Mitrovicën. Për të e bëmat e tij rrëfihen histori pa fund. Ka ndikim në të gjithë veriun dhe ka një emër të shkëlqyer si prijës, gjë që e meriton. Ka ditur të sillet në mënyrë të admirueshme edhe në rrethana të vështira. Iu ka qëndruar besnik, si miqve ashtu dhe atyre që iu shërbente. I qëndroi besnik dhe Princ Vidit, pavarësisht se ky s'vlehte për gjë, vetëm e vetëm nga që i kishte pranuar paratë. Do jetë mirë ta bëjmë për vete, sepse s'është nga ata që do të mbeten neutralë. Flet vetëm shqip dhe keq turqishten. Ka pesë djem dhe dy nipër, që të gjithë të shkolluar. Sipas njoftimeve të fundit (me shumë mundësi të rreme), thuhet se është vrarë në Podgoricë, me urdhër të Malit të Zi.

KOMANDAT I GARDËS PERSONALE TE SULLTAN HAMITIT II

Në vitin 1902, Sulltan Abdul Hamiti II e kishte emëruar Isën komandant të gardës së tij personale, e cila ishte njësi speciale që kishte Perandoria. Natyrisht, sipas traditës, gardistët gjithmonë ishin shqiptarë të rekrutuar me kujdes. Isa Boletini i kaloi katër vite në këtë detyrë, për të cilën gjë Sulltani ia dha titullin bej.

Isa Bej Boletini ishte kthyer në Kosovë, por ia kishte dhënë besën Sulltanit se, nuk do të luftonte kundër tij. Në vitin 1908 nuk i përkrhu deri në fund planet e kryengritësve shqiptarë dhe programin e xhonturqve. Por, çdo gjë ka fund. Që nga mbarimi i vitit 1908, Isa Beu ishte kthyer kundër perandorisë dhe udhëhoqi kryengritjet shqiptare deri në pavarësim të Shqipërisë.

Aubrey Herberti kishte kohë që planifikonte të takohej me Isa Boletinin. Për legjendën e gjallë flitej aq shumë, që nga pallati Yildiz dhe i tërë Stambolli - e deri në cepat më të largëta të perandorisë. Personaliteti i kreshnikut shqiptar e intrigonte tej mase diplomatit, ushtarakun dhe politikanin aristokrat britanik. Ai e dinte se Isa nuk i kishte mbushur as 17 vite kur ishte treguar trim dhe mjeshtër i luftës kundër forcave otomane në betejën e Slivovës në vitin 1881. Mirëpo, armiqësia e tij me sulltanin nuk ishte e përjetshme.

EDHE KUNDER EDHE PRO SERBEVE!

Isa Boletini është një nga luftëtarët e paepur të periudhës së Pavarësisë. Historia ka dhënë plot vlerësime për figurën e tij. Por disa herë, patrioti i njohur shqiptar, është akuzuar për bashkëpunim me serbët apo malazetët. Është akuzuar edhe për organizmin e luftërave kundër perandorisë osmane, për interesat sllave. Sipas Edith Durham, nga ky pohim kuptohet që Serbia dhe Mali i Zi luftonin të kishin ndikimin e tyre në radhët e patriotëve shqiptarë. Gjatë gushtit të vitit 1912 mësojmë, se truproja e Boletinit përfshinte edhe serbë. "Netëve, ai ruhej nga dy serbë në derën e jashtme, dy në të dytën dhe dhjetë shqiptarë myslimanë brenda. Ky fakt provon që pakica serbe ishte në marrëdhënie të shkëlqyera me udhëheqësit kryengritës. Këta të fundit ushtronin një disiplinë të rreptë mes njerëzve të tyre. Idriz Seferi "kishte vrarë disa prej pasuesve të tij, për grabitje të shtëpive serbe". Këto pohime të pa pranuar nga historiografia jone përsëriten në botimet e kohës së sotme të Branko Babiqit (Branko Babić), të Redaksisë Qendrore të Enciklopedisë së Jugosllavisë, të Oliver Shmitit (Oliver Schmit), të Dimitrije Bogdanoviqit (Dimitrije Bogdanović) dokumentet dhe pikëpamjet duhen ballafaquar për të arritur te real historia. Romantizmi folklorik, prirjet për shkruar histori të vogla me gema të mëdha, negativizmi deri në nxije janë flama e historiografisë sonë, aq më tepër mendësisë sonë populiste social fisnore. Konkluzioni stoik se, në pikëpamje të angazhimi njerëzor, politik, luftarak, shtetar, popullor tej Isa Boletini, që prirës i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare të mbarimit të shekullit nëntëmbëdhjetë dhe fillimit të shekullit njëzet dhe themelues i shtetit të trojeve shqiptare...Qofsha i gabuar më përngjanë shumë një vlerësim monumental, si Isa Boletini ashtu edhe Bajram Curri. Të dy ishin prototipa shqiptarë të shekullit të XX. Prijës popullorë krahinorë të llojit më të mire (por as njëri gjithë kombëtare), por disi të ndryshëm për sa i përket dukës, sjelljes po edhe mënyrës së mendimit. Isai ishte prototip i burrit të motit i rregullt, serioz, fjalëpakë, por me një pamje të jashtme të rëndë, tepër i sjellshëm e miqësor e besnik sa s'thuhet. Thuhet se i është kërkuar nga Krahu i Ismail Qemalit te hiqte qafe Esad Pashë Toptanin. Isa ka: - thënë jo kurrësesi. Nuk duhet gjë pavarësia po filluam te vrasim njeri-tjetrin. Që të dy ishin atdhetarë të zjarrtë shqiptarë, edhe pse që të dy ishin krejtësisht analfabetë. Qe te dy kishin fituar titullin e bej nga osmanet dhe mbanin me krenari. Këto gjera ekzistojnë, pse heshtet?! Pse kalohet pa u thënë origjina e tij gjenealogjike nga Pecikaj e Shalës dhe përkatësia tij katolike para 8 brezash?!

PRELË MILANI

Nëpër faqet e historisë së klerit katolik, New York 2024

Falënderoi nga zemra ish nxënësin dhe mikun tim të vjetër (qysh në Shkollën e Mesme të Gjuhëve të Huaja të Shkodrës), Gjon Destanisha Jr., i cili me njoftoi se këto ditë i vjen në shtëpi libri im i ri studimor: “Nëpër faqet e historisë së klerit katolik” (New York, 2024).

Gjon Destanisha Jr., tash disa vjet jeton e punon në SHBA. Babai i Gjonit i ndjeri Nikolin Destanisha, ka qenë një mik shumë i mire i imi, sikurse dy hallat e tij (e ndjera Flora dhe Zhyzeta, në New York) dhe miqtë e mi të hershëm: Luigj Kabashi dhe marinasi amerikan i ndjeri Fran Sokoli, babai i të cilit është vrarë barbarisht nga komunistët serb në Kosovë...

Pak histori për Gjyshin e përbetuar antikomunist dhe antiserb të Gjon Destanishës Junior:

Kapiten Gjon Destanishës, me gradën e kapitenit në Mbretërinë shqiptare, ishte komandant i Ushtrisë në Qarkun e Shkodrës. Gjoni para ekzekutimit në Prishtinë, tha: “Rrnoftë Shqipnia, rrnoftë Flamuri Kombëtar!”

Gjoni, lindi në vitin 1900 në Gimaj të Shalës së Dukagjinit, ndërsa gjatë Luftës së Dytë Botnore, si ushtarak luajti rol të rëndësishëm në Kosovë, por që askush nuk di si u arrestua nga partizano-çetnikët serbë dhe përfundoi në Burgun e Prishtinës, pasi në mungesë u dënua me vdekje. U ekzekutua në vitin 1951 nga serbët, në moshën e re 51-vjeçare. Në Kujtimet e Gjokë Spaçit të përmbledhur në librin: “Testamenti i fshehur” (Prishtinë, 1973), mësojmë se shkodrani Gjon Destanisha, i kishte rënë shorti për të bërë atentatin ndaj themeluesit të Partisë Komuniste të Shqipnisë (PKSH) Miladin Popoviqit. Ai ishte i gatshëm t’u bënte këtë, por meqë Haki Taha kishte sëmundjen e tuberkulozit dhe pasi besonte se brenda pak muajsh do të ndërronte jetë, ai u zotua që vet t’u kryente atentatin kundër M. Popoviqit, të cilin edhe e vrau më 13 mars të vitit 1945 në Prishtinë.

Gjoka e përshkruan personalitetin e Kapiten Gjon Destanishës kështu.

“Aty gjetëm edhe një antikomunist të betuem, por fatkeqësisht që jetëshkurtë. Ai ishte kapiten, Gjon Destanisha. Mendoj se ashtu e kishte ngallëpin, por shokët e tij të mjerë, në rast se ndonjeni nga ata janë gjallë, do t’ia dinin saktë ngallëpin. I ndjeri ishte dënue me vdekje dhe ia kishin vnu prangat në secilën kambë nga 25 kg. Ia kishin caktue vendin afër derës. Ndoshka kjo ndodhi që të mos ua prishte gjumin dhe qetësinë të burgosunve nga ato vegla qorre të Drejtoratit të burgut. Kur e pyetëm pse je vendos këtu te dera, ai na tha se vet e ka zgjedhë këtë vend, që të mos ua prishtë qetësinë të burgosunve me rropamat e hekurave! Më lejo zotni lexues, që t’i shkruaj pak fjalë për këtë burrë të martirizuem, mbasi për Kosovën tonë, ai ishte prej Shqipnisë së Vjetër.

Gjon Destanisha, ky martir i atdheut, në kohën e Shqipnisë kishte pas qenë kapiten i Ushtrisë shqiptare. Bashkë me një togë ushtarësh, xhandarësh dhe me do ballistë kishte pas shkua në katundin Suhodoll ku e kishin pasur çerdhen komunistët e drazhistët dhe aty e kishte pas krye një aksion të madh. Se si ishte arrestua nuk e dinim hollësisht, por atë e kishin dënue me vdekje. Gjykimi i tij, domethanë qëndrimi i tij gjatë gjyqimit, ishte shumë burrnor e i pathyeshëm. Ashtu qëndroi deri natën e fundit të jetës së Tij. Gjon Destanisha u jpte kurajë të gjithë të burgosunve. Të gjithë të burgosunit shqiptarë, përveç komunistëve, ibeistëve dhe spiunave, përpara se të shkojmë ne, e kishin dashtë dhe përkrah si vëllaun e vet. Të gjitha gjanat ushqimore që u kishin pas ardhë të burgosunve, prej më të mirave ia kishin pas dhanë kapiten Gjonit. Si mbërritëm në atë dhomë, Gjon Destanisha e ndjeu veten si të ishte në Kompaninë e vet. Ai ndjeu sikur i erdhi Ushtria shqiptare e vendosur për vdekje. Bisedat e tij ishin plot ideal dhe në çdo fjalë na thoshte: – Djema, mos u mërzitni se keni me ja mbërritë qëllimit! Po e shkurtoi këtë bisedë të zotni Kapitanit. Nji natë në ora një mbas mesnate, kur të gjithë të burgosunit ishin në atë gjumin e mallkuem, u hap dera, brenda hynë tre civilë dhe me za të vogël e çuen Gjonin prej gjumi. I thanë hajde se po të thërrasin në Drejtori, sepse ka ardhë vendimi në interes tandin. Unë thashë se kjo ndodhi kur ne ishim në gjumë, por lexues i dashtun, gjumi në ato vende asht si gjumi i peshkut në ujë. Gjithmonë fle syçelë. Kur ata të mallkuem hynë në dhomë, sytë tonë panë dhe veshët na dëgjuan si fjalët e të mallkuemve ashtu edhe fjalët e jetëshkurtit. Ata u munduan ta nxjerrin tinëza nga dhoma, por Gjoni me za normal u përgjigj: – Po, po ... E di! Megjithëse ata nuk deshtën me lanë me folë, Gjoni i foli fjalët e mbrema me neve dhe njiherësh ishin fjalët e fundit të jetës së tij kur na tha: – Burra! Ma bani hallall dhe ju faleminderit për respektin që më keni ba dhe ndihmën vëllaznore që ma keni ofrua. Mos u mërzitni aspak! Këto ishin fjalët e tij me ne”

Dritë pastë Shpirti i Tij!

E rrëmbyen rebelçe. E nxorën prej dhomë dhe e mbyllën derën. Afër derës në koridor e kishin pas sjellë farkatarin me ia thye prangat. Të rrahurat e çekicit u ndien disa herë, pastaj u dëgjuan edhe fjalët e Gjonit...” Mbas Luftës së Dytë Botërore, bashkëshorten e Gjonit, Antoninën, tri vajzat dhe djalën e saj, regjimi stalinist i dërgoi në internim për 25 vjet me radhë. Antonina ndërroi jetë në nëntor të vitit 1987 në Shkodër.

Përgatiti:
Klajd Kapinova



Çifti Antonina e kapiten Gjon Destanisha



GJUHA E PUSHTETIT DHE EZOPI I MADH



Angela Kosta, akademike, shkrimtare, poete, eseiste, kritike letrare, redaktore, promovuese, gazetare

Fatkeqësisht në ditët e sotme, miliona njerëz vdesin nga uria, sëmundjet dhe luftërat e pakuptimita dhe të pafundme. BOTA po rrokulliset marramendëse dhe e frikshme, duke nxjerrë jashtë normalitetit të gjithë njerëzimin, aty, ku gjëmimi i tmerrshëm, do të lëvizte edhe vetë malet, ja pse jemi të çoroditur nga gjithçka që po ndodh kohët e fundit. Planeti ynë është shndërruar në një trup të unifikuar dhe të heshtur; i vetëburgosuri i ekzistencës së tij, pa asnjë lloj ndjenje humanizmi.

E gjithë toka jonë, vetë rruzulli tokësor, njerëzit dhe ajri që thithim, shpejtësia mashtruese dhe e çmendur e vrapimit të pandalshëm për të kënaqur egon tonë, na bën të harrojmë detyrimin e përljes dhe të gjunjëzimit, përballë atyre të cilët nuk janë të barabartë me ne. Mjerisht jemi në duart e atyre që qeverisin popullin sovran.

Meqenëse kohët e fundit veshët tonë dëgjojnë të gjitha këto dhe shpeshherë fjalë pafund ziliqarësh, më vjen ndër-mend Ezopi i Madh. Do të doja ta kisha takuar personalisht, sepse vetëm kështu mund ta kisha mësuar dhe vlerësuar më

mirë tregimin për dëmet e "Gjuhës" në shkrimet e tij. Shumë prej jush duhet ta dinë historinë... Ksanti, padroni i Ezopit, ftoi disa njerëz për darkë dhe i urdhëroi Ezopit të blinte të gjitha gjërat më të mira si edhe ato më të këqija që kishte në treg. Ezopi premtoi se do ta kryente këtë urdhër patjetër. Por gjatë banketit Ksanti dhe të ftuarit e tij vunë re se Ezopi shërbeu në tryezë gjithnjë dhe vetëm gjuhë derri. Ata mermërisnin me zë të ulët: Ja, prapë gjuhë po na shërben. "Pjatanca e parë ishte ajo e gjuhëve të gatuar, edhe e dyta po ashtu, sikurse pjatanca e tretë". Ezopi nuk shërbeu asgjë tjetër veçse gjuhëve.

Oh, çfarë feste, vërtet e pakëndshme! Ksanti besonte se shërbëtori po tallej me të ndaj i bërtiti: "Pra, o i poshtër, i ke lënë pas dore urdhrat e mia?" Dhe e siguroi atë se do ta ndëshkonte me një dënim shumë të rëndë.

Fare i qetë Ezopi iu përgjigj: "Zotëri, ti më urdhërove të shërbej ushqimin më të mirë dhe unë gatova gjuhë. A nuk është gjuha që me ëmbëlsi lidh miqësi dhe shpreh dashuri? Pastaj më urdhërove të shërbej ushqimin më të keq. Çfarë ka vërtet më keq se gjuha? Çfarë është më e neveritshme? Dihet o njeri, që njerëzit shqiptojnë me gjuhë të gjitha mallkimet, fyerjet, gënjeshtat, këshillat e këqija; dhe gjithashtu, po ata, me anë të gjuhës përm-bysin principatat, perandoritë".

E pra, gjuha e ligë është shkaku kryesor i të gjitha të këqijave dhe fatkeqësive tona. Thuhet se Ksanti nuk tha më asgjë, sepse mbeti pa fjalë nga zgjuarsia e Ezopit. Me mençurinë e tij, Ezopi na la si trashëgim të kuptojmë se, edhe në ditët e sotme "gjuha" shërbehet dhe nderohet pa mundur ta dallojmë nëse është "e keqe" apo "e mirë!" Ka mbetur pak për të konfirmuar dhe për ta fokusuar këtë të fundit, sepse vetëm

"Gjuha" do ta bënte këtë. Fatkeqësisht sot jetojmë në një shoqëri ku ka mbetur pak ëmbëlsi dhe miqësi e vërtetë. Me siguri gjuha do të kërkonte pritshmëri afatgjatë, veprimtari nëse do t'i jepej mundësia. Ajo vetë do të ndjehej në siklet nga çka del nga goja e atyre, që nuk bëjnë gjë tjetër veçse shpifin dhe investojnë për keqdashjen në bashkëpunim me vetë djallin. E pra çfarë na mbetet të themi në fund?

E dashur "Gjuhë" hyr pak në grevë, sepse ndoshta, vetëm kështu do të mundesh të gesh armëpushimin dhe paqen e perënduar me kohë, dhe vetëm kështu nuk do të kishe asgjë tjetër për të thënë apo për të shtuar.

Ti e di fare mirë se cinizmi yt ndalon në sytë e pushtetarëve të tu, të mbushur me lumturi kur shikojnë njerëz të stërmunduar dhe të shtypur prej dhunimit të tyre, dhe është pikërisht aty, në atë moment kur ndjehet niveli i ftohtësisë, hipokrizisë dhe egoizmit tënd. Poshtërsia jote vishet me buzëqeshje të rreme, ndërsa ti gjuhë godet buzët dhe lëshon me ashpërsi fjalët, jep urdhra për luftë, gjenocid masive, zhdukje etnike, kundrejt të pambrojturve dhe të pafajshmëve. Por pafuqia e gjithë njerëzimit kundrejt teje, nuk ka të bëjë aspak me hakmarrjen. Thjesht ringjall në to, këmbënguljen për të vazhduar mos-braktisjen e ëndrrave të tyre. Nga gjuha jote dalin fjalët e atyre që kanë pushtetin në dorë, të cilat janë bërë si këngë e pandalur, e mërzitshme nga veprimet e vazhdueshme të pasinqerta. Ti me pushtetarët e tu, gëzohesh dhe duartroket humbjen momentale të pafajshme, kurse populli jeton dhe shijon atë çka sheh nga shkalla e fundit e triumfit tënd, që do të të çojë atje ku i lejove me ambicie vetes të arrijë. Mos beso që ti gjuhë dhe ata të cilët të zotërojnë, jeni arka e çmuar që ruan me xheloz

çelësin që do të hapë derën e së ardhmes. Askush nuk është pronar i botës apo i të tjerëve; gjithkush e mbart vetë këtë çelës drejt rrugëdaljes së shpëtimit. Është Zoti ai, i vetmi, që cakton fatin, ditët, ëndrrat, projektet, por mbi të gjitha, na i rezervon këto të mira nëse e duam njëri - tjetrin pa armiqësi. Në të kundërt një ditë, Ai të jep atë çka të kuptosh sesa të drejtë ka dhe sa i plotfuqishëm është. Atë ditë ti gjuhë dhe kush të zotëron, do të vajtoni falimentimin total, ndërsa njerëzimi do të buzëqeshë më në fund i lirë nga robëria jote. Vëzhgo mirë luftimin e të shtypurve, mos i nënvlerëso, sepse ata do të arrijnë atje ku mbaron pushteti yt. Atë ditë, shpresojmë jo shumë larg, ndryshe nga pushtetarët, njerëzimi nuk do të vendosë maskat e gënjeshtres, sepse nuk do të jenë kurrë të ngjashëm apo bashkëpunëtorë të ligësive të etur për lavdi, dhe ndërsa sunduesit do të fluturojnë pa krahë, lëkura e shpirtit të etjes së tyre për pushtet do të përqafojë vetveten në humnerë, duke çliruar kështu të pafajshmit nga robërimi i tyre. Njerëzimi do të vazhdojë të jetojë, gjuha e pushtetit për fat të mirë jo më. Siç e sheh, humbja e momentit ndryshe nga e jotja, ka një afat fare të shkurtër. Njerëzimi e shpreh pa kushte dëshirën për të përshpejtuar fitoren, kërkon përsosmërinë e vërtetë, të pastër, pa mediokritet, për të jetuar në mënyrë të hijshme, me krenari, pa injorancën e degdisur prej kohësh. Fundja thjesht duhet t'ju falënderojmë pushtetarë dhe diktatorë, sepse njerëzimi ka aq forcë që të kundërshtojë pesimizmin tuaj të shkatërruar dhe të dëmtuar prej shekujsh.

Njerëzimi sfidon gjithçka, ndaj buzëqesh pa cinizëm, pa përplasar kokën pas murit, pa e mundur mendjen për ambicie, pa ndjerë dhe pa çorientuar dhimbje fizike dhe psikike.

YJET SHKËLQEJNË NË QIELL!

Në kujtim të rapsodit Prelë Marku

I përjetshëm qoftë kujtimi yt artist!

Bilbili i këngës, djali i Planit të Dukagjinit, miku i mirë i kujtdo që të njohu në jete, Krenaria e folklorit, dashnori i vjetër i çiftelisë fyellit e lahutës, djali këndshëm i festave dhe veprimtarive tona në vitet 80'. Emigranti i hershëm, që hapi zemrën dhe shtëpinë për miq e shokë atje në Amerikën e largët, por na mungove ne këtu në Shqipëri.

Yjet shkëlqejnë në qiell këtë e kam ditë me kohë, por kurrë nuk do të besoja se Nëne Tereza do të kërkonte ty kaq shpejt në Parajsë. Kurrë nuk do të doja, që pas Lek Ndout dhe Pëllumb Tefës, një tjetër bilbil i këngës të pushonte para kohë në Parajsë.

Me krenarinë e emrit tënd, me lotin e familjareve dhe miqve tuaj, me kujtimin e kolegeve, me emrin dhe lavdinë që le pas, në një vjetorin e amshimit tuaj mendova

të shkruaj dy fjalë kujtimi.

Le të jenë këto rreshta një kurore me lule për ty nga gjithë djemtë e Planit, Pultit e Dukagjinit, nga shokët tu që në rininë tonë të hershme të duartrokitem në festën e Qereshit, në Theth e Breglumi, në Vau Dejës e në Shkodër.

Le të jenë këto rreshta kujtimi i pavdekshëm për Ju nga skenat e festiva-leve folklorike kombëtare e ndërkom-bëtare, le të jetë një fllad që fshin lotin e dhimbjes dhe rrit jehonën e krenarisë tek familja juaj. bjeshkëve të Dukagjinit, kudo ku ka Shqiptar kënga juaj do dëgjohej si jehona e zanave, kujtimi juaj në odat e folklorit do ta mbetet gjithmonë i gjallë.

Çdo brez, çdo kohë ka nevojë për sh-embuj pozitiv, për pika referimi dhe frymëzimi! Pra, ju ishit njeri nga ata miku im i pavdekshëm. Hijeshia që ta kish fal Zoti, rrit tek ti me kulturën dhe edukatën, fisnikërinë dhe bujarinë që të dha familja.

Talentin si artist i fjalës dhe këngës e rrite nder vite, e fati të buzëqeshi atëherë kur duhej. Ndoshta vet Zoti e rriti emrin tënd, e bekoj rrugën tënde drejt Amerikës, për të krijuar atë familje të bekuar, për të mbështet vëllezërit e miqtë tuaj.

Repertori juaj artistik është si një ylber me ngjyra në gjerdanin e artistëve të Du-

kagjinit, në Trevezën e këngës folklorike, emri juaj është i shkruar me shkronja ari, i bekuar nga talenti juaj, Aty në Miçigan, por edhe në Nju Jork lahuta e kujtimit tuaj gjithmonë tjerre elegji për Ju.

Gjithmonë do ti kujtojmë me krenari rapsoditë tuaja të e këngës kreshnike, lirikat tuaja të buta do të kthehen ne vaj, e lutjet për ty do ti drejtojmë nga qielli. Kurrë nuk do doja të shkruaj elegji për ty miku im, kurrë nuk do ta besoja se Nëne Tereza do ta pëlqente aq shumë këngën që ja këndove sa të merrte para kohe në Parajsë, por ja që yjet shuhën në mëngjes për të ndriçuar ditën e njerëzimit.

Ti ishe i veçantë për mua, për shoqërinë, për familjen, për artin dhe për folklorin, ishe një me-teor që ike para kohe në qiell, ike për të shkëlqyer gjithmonë. Nuk dua të tregoj se sa na mungon, por dua të them se jemi shumë krenar për ty. Nuk dua të them fjalë vaji, sepse burrat janë për këngë, dua të them lavdia përm-bi lotin, sjell krenari.

Ju jeni krenari! Krenar për ty duhet të jetë gjithmonë familja, bashkëshortja, vajza, djali, vëllezër dhe motra.

Jeta e juaj ishte dhe do mbetet pasuri shpirtërore dhe kombëtare, aset i trashëgimisë tonë kulturore.

Të jetosh dhe të vdesësh është e zakonshme për gjithçka, por të jetosh dhe të mbetesh i pavdekshëm këtë fat se kanë të gjithë!

Ju jeni një nga miqtë e mi të pavdekshëm!

Ju jeni krushku i përjetshëm i folklorit!

Ju jeni dhe do mbeteni krenaria e artisteve të Dukagjinit!

I përjetshëm qoftë kujtimi emri dhe lavdia juaj, Prele Marku!

Me respekt Lulash Brigja



I gjithanshmi Ndue Ziçi

Gjithmonë kur shkruan në mendje të koncentrohen mendimet. Të shkruash për shokët është e vështirë, aq më tepër kur shkruan për një intelektual, i cili gjithë jetën ka punuar drejtues dhe ka spikatur aftësia, komunikimi, bashkëpunimi e thjeshtësia. Këto cilësi kanë bërë të respektohet. Në vendlindje e kudo ku ka punuar, duke filluar nga Tropoja, Lezha, Shkodra e të tjerë. Këtë shkrim ja kushtoj z. Ndue Ziçi nga Thethi. Në pamjen e pare e kupton se është Thethjan. Në paraqitjen e tij, kupton se ka marrë shumë nga bukuritë e kësaj treve. Po jo vetëm këto, por edhe zgjuarsinë, burrërinë, besën e të tjera.

Kush është Ndue Nikoll Ziçi?

Ndue Ziçi lindi me 13 qershor të vitit 1946. Djali i Nikoll Gjergjit dhe i Lenë Lulashit (e bija Lulash Malës nga Lekajt e Shalës). Shtëpia të njohura në Dukagjin e më gjerë. Lindën tre fëmijë një djalë e dy vajza. Ndojnë, Agen dhe Dranden, kanë familjet e tyre e bëjnë jetë normale dhe janë të lumtur. Shkollën 7-vjeçare e mbaroi në fshatin e lindjes. Me të gjitha notat "5" e konvertuar në notën "10".

Duke biseduar me Ndojen ai: kujton me nostalgji mësuesit, për të gjithë ruan - respekt e në veçanti për Drejtoreshën e pare, e cila çeli shkollën 7 vjeçare në Theth. Fjalën e kishte për Prenda Pjetrin (Lelçaj), e cila nuk jeton më. Ndonëse kanë kaluar mbi 60 vite e ende e mban mend firmën e saj, kur ju vinte notat. Janë dhjetëra e dhjetëra mësues e pedagog, të cilët i kanë dhënë mësim, po zj. Prenden nuk e harron kurrë.

Një episode, që tregon Ndoja. Ishte viti 1959, kur në fshatin Theth vjen Beqir Balluku, ish Ministër i Mbrojtjes, viziton edhe shkollën 7-vjeçare. Pritet nga Drejtoresha dhe një grup nxënë-

sish të dalluar, në mesin e të cilëve isha edhe unë. Kisha lëshuar trup, pra isha i gjatë. Çfarë nxënësi është ky? Drejtoresha i përgjigjet: i shkëlqyer,



madje e kemi edhe komandant Çete. Ta marrim për në shkollën e mesme të përgjithshme "Skënderbej". Në momentin që shoqëruesi i tij, nxori një bllok shënimesh, shoqëruesi nga Thethi i tha: ka diçka në biografi. Ai siç kishte fytyrën kishte edhe zemrën. Drejtoresha aty për aty më përkëdheli, duke më thënë je i shkëlqyer, ja dha përgjigjen sy në sy. Pastaj e mobilizojnë në ushtri, në brigadën e N/detëve, në Pashaliman në Vlorë. Shërben për 4 vite në N/detesen e pare. Për 3 vite ka qenë sekretar

i Rinisë. Është shpërblyer disa herë me leje e të tjera.

Etja për të vijuar studimet nuk ju veniten asnjëherë. Vazhdojë shkollën e mesme ekonomike në Berat. Këtu filluan edhe ndryshimet e jetës. Njihet me Shuke Lojzin, vajzën e Gjin Sokolit nga Gimajt e Shalës. Familje dhe shtëpi e mirë, me të cilën martohet dhe krijon familje. Shkollën e mesme e ka përfundua me note mesatare 9.5. Në vitin 1971 vijon shkollën e lartë në fakultetin Ekonomik, të cilën e përfundojë me note mesatare 8.5 Gjithë shkollën e ka mbarua me shkëputje nga puna. Pas përfundimit të fakultetit ekonomik, emërohet në rrethin e Tropojës. Ka punuar rreth 20 vite në detyra e funksione të ndryshme. Puna e tij është vlerësua nga kolegët dhe punonjësit si dhe institucionet e kohës, për thjeshtësinë, ndershmërinë e përkushtimin në plotësimin e detyrave. Në rrethin e Tropojës u bë një kuadër i rëndësishëm, fillimisht u emërua. Shef plani në

Kooperativën Bujqësore Babinë. Pastaj në Kooperativën Bujqësore në Llugaj. N/kryetar kooperative, Kryetar, Sekretar Byroje, Instruktor në Komitetin e Partisë të Tropojës. Pas viteve 1991 është emëruar shef plani në Degën e punëve të Brendshme të Tropojës. Në vitin 1992 është titulluar oficer me funksion specialist në sektorin e logjistikës.

Në janar të vitit 1993 transferohet nga Tropoja për në Degën e Punëve të Brendshme Lezhë. Fillimisht emërohet oficer informacioni, Komandant i

Policisë të Portit Shëngjinit, Komandant i Policisë Rrethit, Shef logjistike në Drejtorinë e Policisë Qarkut Lezhë dhe së fundi Shef logjistike në Repartin e Ndërhyrjes së Shpejtë në Shkodër, ku del në pension.

Ka një familje të shkëlqyer dhe intelektuale. Bashkëshorti, Shuke ka punuar mësues për shumë vite deri kur ka dal në pension. Albani, djali ka mbarua fakultetin dhe master profesional. Është biznesmen. Është i martuar dhe ka një familje të shkëlqyere. Vajza e madhe Klea, është në vitin e fundit të fakultetit Ekonomik në degën Informatik - Ekonomike, studente ekselente.

Një prirje e Ndojës e ka hershme ka qenë të shkruaj në gazeta. Fillimet i ka qysh nxënës, ka botuar shumë shkrime në gazetën "Pionieri", "Zëri i Rinisë", "Luftëtari", "Zëri i Popullit", "Bashkimi", "Panorama", "55" e të tjera. Në gazetën lokale: "Shkëlzeni" të Tropojës, "Liss alba" të Lezhës, gazeta e "Alpeve". Shumë vite shkruan në gazetën "Dukagjini", është edhe anëtar i redaksisë.

Një pyetje e bërë, ku e ka gjetë veten më shumë?

Ai përgjigjet me një buzëqeshje: - Te origjina, çka kupton se te gazeta "Dukagjini". Për punën e mirë z. Ndue është vlerësuar me shumë stimuj moral e material, për të cilat ai vet nuk është dakord që ti përmendim. Tani është në pension dhe punon në një kompani shumë serioze. Theksojmë se pas daljes në pension është nderuar me tituj si "Mirënjohje e Qytetit të Shëngjinit" dhe me titullin "Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini"!

Ne i urojmë z. Ndue shëndet të plote e lumturi në familje dhe pune te palodhur në gazetën "Dukagjini"!

Përgatiti,
Fran Marku,
nëntor 2023

U nda nga Jeta Mirash Zef Shytani - Ndrezaj

Mirash Zef Shytani nga fshati Vuksanaj i kramshinës së Shalë ishte një nga figurat më të shquara të arsimit e kulturës në Dukagjin. Ai, ishte një intelektual e punëtorë i jashtëzakonshëm, familjar model, e zote shtëpie i suksesshëm, i thjeshtë, popullor dimensional dhe vizionar, nga një familje me tradita patriotike dhe atdhetarë nga me të mirat në Dukagjin dhe më gjerë.

Mirash Zefi lindi në fshatin Vuksanaj, me 14 Gusht 1926, i biri i Zef Shytanit e Zoje Pal Ukës (Arra) Toplane (bije e një familje me rrënje te thella pune e atdhetarizmi, si shtëpia e Ndue Deli Ukes (Arra) Toplane).

Baba i Mirashit, Zef Shytani, ishte një burrë punëtorë, i kamur, patriot e atdhetare, i cili mori pjese aktivisht me bashkoheshit e tij më në zë të Dukagjinit dhe më gjerë në lëvizjet për Pavarësi e Liri. Ai bashke me kushëririn e tij, Mark Preka janë të njohur në Shalë e Dukagjin si burra shumë punëtorë, shpijanike, mikpritës e të kamur. Prindërit e tij, Zef Shytani e Zoje Palja patën 8 fëmijë. Ata, megjithëse

vet ishin të pa shkollë, por në gjendje të mirë ekonomike, që ndikoj për mundësimin e shkollimit të fëmijëve të tyre dhe në veçanti të Mirashit e Gjonit.

Mirashi klasën e pare të shkollës fillore e filloi në vitin 1935-1936, në fshatin Abat, në një shtëpi private, të Gjelosh Sokolit, me mësues Frano Preçin, duke shkuar çdo dite në shkollë nga fshati Vuksanaj në Pjollë-në Nicaj deri në Abat nëpër tre fshatra pasi në vitet 1935-1936, në kohën e rrëgjimit të Ahmet Zogut nuk kishte shkollë fillore në çdo fshat. Në atë kohë kishte shkollë fillore vetëm në Theth e hapur 1917, në Abat, në Kodër Shëngjergj dhe në Xhan, të cilat here hapeshin dhe here mbylleshin. Mirashi pasi shkoi pak kohe në Abat, në klasën e pare u largua nga shkolla e Abatit dhe shkoi në shkollën fillore Lotaj, në Kodër Shëngjergj, në



qendrën e Nënprefekturës së Dukagjinit. Shkollën fillore e mbaroi shkëlqyeshëm në vitet 1939-1940, megjithëse në kushte mjaft të vështira, duke udhëtuar në këmbë nga Vuksanaj në Kodër Shëngjergj, që shpesh here merrte ushqime me vete, duke fjetur tek mësuesi i tij me origjinë kosovare, Adem Nikshiqi, i cili jetonte me të shoqen Lirie Nikshiqi, në shkollë, duke qenë nxënës shumë i mirë, mësuesi, me gjithë grua e donin shumë.

Mirashi mbasi mbaroi shkollën fillore shkëlqyeshëm me disa shoke të tij: Gjoko Pjeter Voci (Marku) nga Nenmavriq, Vate Gjelosh Niken e Mirash Zef Preken nga Lekaj, Mhill Pjeter Micin nga Pylaj -Shosh, Mhill Leke Camen nga Kodër Shëngjergji, Mark Gjergj Binakun nga Pepaj, Ndue Prend Kacolin nga Pecaj, Nike Sykun nga Kaprrea (përgjegjës), Nikë

Gjon Niken nga Breg Lumi (instruktor), Gjin Kole Avdine nga Gimaj dhe shumë të tjerë nga krahina e Shalës, Shoshit e Pulti, që kishin mbaruar shkollën fillore shumë mirë në Theth, Abat, Kodër Shëngjergj e Xhan dhe pasi kryen një kurs dy vjeçar për mësues, filluan punë në arsim në Dukagjin në kushte shumë të vështira për zhdukjen e analfabetizmi e shkollimin e brezit të ri.

Mirashi, në vitet 1942-1943, kur ishte 16-17 vjeç u rreshtua në lëvizjen antifashiste Nacional - Çlirimtare dhe më pas në Kodër Shëngjergj, në detyrën e intendent (magaznier ushqimesh) me komisar Mark Ulin e komandant Xhevdet Gavoçin (vëllai i Qemal Gavoçit) e zëvendës komandant Kolë Gjon Marashi nga Brashta -Shosh dhe më vonë u transferua në Brigadën e Ndjekjes, në Regjimentin Autonom të Shkodrës. Më vonë në zonën Pukë-Mirdite, me komandant Mat Doden e Komisar Politik Bardhok Biben nga Mirdita, në zonen e Shpalit në Mirdite, në Selite afër Peshkopisë

*** Poezi nga Life Hasa *** Poezi nga Life Hasa *** Poezi nga Life Hasa ***



MIQTË E MI

Ju shesh më mungoni
o miqtë e mi,
më ka marrë malli për zhegun
e vapës,
për dimrin me shi.
kur kalonim me një kafe,
në bar luks a snack,
kur me fjalët bënim tregti.
Kur fjala bwhej komerc
për paqe e njerëzi.
Ju nuk jeni princër,
as mbretër,
as pasanikë të vjetër,
dhe kafja që pini
kushton vetm 300 lekë,
kostumi shumë i lirë,
diploma nuk kushton,
as rrojtja juaj.
Po kush mund ta blinte
shpirtin tuaj, kush?
Cilido princ a mbret
do të ishte i varfër para jush.

Më thoni, miqtë e mi,
sa kushton çmimi juaj;
unë jam larg, shumë larg
e kudo jam e huaj.

Vetëm me ju, jam e vërtetë
si stinë e plotë,
si lum i qetë,
si sofër e shtruar me tupanë.

Më këndon, miqtë e mi
vetëm një këngë,
"Mbeçë, more shokë, mbeçë".
Ju nuk keni makina luksoze,
ju s'keni shërbëtorë,
bota pa ju do të ishte një hiç,
s'do kish triumfatorë.

Të nderuar miq,
ju jeni ambasadorë
zogj të qiellit,
legjislatorë.
Ju jeni të pavdekshmit
me laps e letër
edhe pse të ndërrojnë
princ e mbretër!

SHTATOR 1980

Kur Ulqin të thashë lamtumir'
e kisha vështir'.
Kur pas ktheva sytë e të pash'
O Zot, kur kam me u kthy,
thash'?!
Kur Zemra rrihte e fliste shqip
E kur kënga e vallja jehonin
në kala,
lahuta e çiftelia.
O Zot, - thash'
Kjo asht mrekullia!
Përqaftime e shtërngime duarsh
në Kala të Ulqinit
Në emër të gjakur, dashnisë
e përmallimit.
Ato duar e përqaftime mbetën
në kujtesë,
Në ajri u shpërndan'
E Shqip fliste, toka nën kam'.

I mora lulet nga vajzat e tua
si motra motrës
Ato buqeta që kurrë
si kam harrua

I ktheva sytë e loti pikonte
si gurrë,
E thash', - se s'do kthehem
më kurrë.
Ti shoh bukuritë e hiret e tua
Që na i kanë
ndalua?!
Bukurinë që zoti ta ka fal
A thu dikush prap' ka me ndal?!
Prap' po du me shetit, me u çmall
Besa me kja
Pse Ulqin na paskan nda?!

U ktheva dhe një herë në Kala,
Me të madhe Zotit i thirra:
Kush na ka nda?!
Zot kush na ka nda?!

Po shpejt shpirtin e zbuta
E vështrova detin pa skaj
Disa lule hodha e pikat e lotit
përmbi,
Thash', Ulqin do kthehem përsëri.

Me Ansamblin " Puka"
U nisa për Shqipni,
Malli më kish kapluar
Të kthehem përsëri.
Shtator 2022,

HESHTJA

Heshtja që godet sa mijëra fjalë
desha ta lë ikonë,
ta vendos në altar.
Në oda burrash, e tek ndonjë
parlamentar
muret i thyen e mbetet e gjallë.

Heshtja,
askush ma bukur s' godet,
nuk bërtet,
ajo nuk sillet vërdallë
të mbërthen, të vë në siklet
të rrin përballë.

Me mantelin e mbretërisë
apo të paqes, të luftës, apo vrasjes
ajo s' ka kufi.
Asht e pamatshme në kohë
e hapësin'.
Asht flori në peshë
qëndron bukur, kandshëm
ndihet mbretëreshë.

Shpesh vret, qorron, shëmton
gjithçka ka brënda në forcë
e zakon.
asht e vështirë, të kap për fyti
e s' të lëshon.
Heshtja ka forcën e gurit, murit
e shpesh zotërve ua kalon.

Ka ligjet e saj, konturet,
fasadat, kolorin që t' lë pa fjalë.
Ndaj besoni në vërtetësinë e saj.
Në bukurinë e magjepsjen
që Zoti ja ka falë,
në fluturimin e magjishëm,
në trokëllimën e lavdinë pa skaj.

Besoni në skuqjen e adrenalinën
shpërthimin kur bulëzon
drithërimën e shpirtit në pasion.
Besoni, në çdo gjë besoni
rreth saj!
Besoni në vetminë
që përmbush një oqean,
që sjell furtuna, stuhi skaj
më skaj,
e kthehet në guaskën e saj.

Asht vetvetja në llojin e luftës
që posedon
asht arma që të mbron.
Duhet bukur me mat' me përdor'
ajo, askund nuk rri me zor.
Por bukur e si në mbretëri
din të bëjë çudi,
sa mijëra fjalë, ligje e stoli
sa, kur ajo gjen Paqe e qetësi.
Në muajin qershor 2022

◀ dhe në Lufaj, në detyrën e magazinierit, për ushtrinë Partizane.

Mirashi, Shërbimin ushtarak e kreu në Divizionin e Mbrojtjes Popullore, në Tiranë, në vitet 1948-1950, ku u shqua për cilësi të veçanta dhe përgatitje të larte ushtarake e shoqërore .

Mirashi, shkollimin 7-vjecar e të mesëm i mbaroi në Tiranë dhe pastaj shkollën Normale në Elbasan. Pas mbarimit të shkollës, Mirashi u martua me Zojen Preken e bija e Prek Gjeloshit nga Qeta e Lekajve të Shalës, një familje e njohur në Dukagjin për vlera atdhetare e patriotike. Ata patën 8 fëmijë, 7 vajza dhe 1 djalë (Sokolin), të cilët i shkolluan në profesione të ndryshme, për ekonomi , veterinarin e mësuesi, duke jetua e punua në mënyre

shembullore ashtu si i edukoi e i dëshironte ai.

Mirashi punoi në detyrën e mësuesit në fshatin Xhan disa vite, pastaj në fshatin Toplane e Brashte dhe në vitin 1962, në moshën 36 vjeç mbaroi pa shkëputje nga puna institutin e larte Pedagogjik në Shkodër, në degën Bio-Kimi dhe u emërua mësues Bio-Kimi në shkollën 7-vjeçare në fshatin Palaj –Shosh disa vite dhe më pas në shkollën 7-vjeçare në fshatin Ndreaj deri në vitin 1970. Pastaj e transferojnë ne shkollën e fshatit Gimaj, Abat e Vuksanaj derisa doli në pension në vitin 1982 .

Ai punoi me pasion e përkushtim, me vullnet të larte, me dashuri e këmbëngulje, me ndershmëri e ndërgjegje të larte,

me kompetence e autoritet, me profesionalizëm e takt pedagogjike për 43 vite me rralle, në armatën e madhe të arsimit për, edukimin e formimin e dhjetëra dhjetar brezave të rinjsh me dashuri për pune, dije e kulturë, duke bashkëpunuar kurdoherë me respekt me koleget, prindërit dhe nxënësit, duke dhanë një kontribut të shquar në zonën e Dukagjinit.

Ai është vlerësuar nga opinion publik, me tituj nderi nga populli e bashkëpunëtorët e tij: Punëtorë shembullor, Zëri i së vërtetës, Standard i gjykimit, Teknokrat i paanshëm, I pavarur e Profesionalist i dalluar.

Kryesia e Shoqatës Atdhetare 'Dukagjini' me rastin e 100 vjetorit të arsimit në Dukagjin -7 Shtator 2017 e ka nderuar

Mirash Zef Ndreaj me titullin - " 100 vjet Arsim e Kulture në Dukagjin".

Me ndarjen e tij nga jeta me 3-12-2023:
- Familja humbi - Prindin e tij të dashur!

- Fshati Vuksanaj, Shala e Dukagjinit
- Mësuesin Shembullor e punëtorin e pa lodhur!

- Shokët, miqtë, Kumbare e Dashamire
- shumë të respektuarin e tyre!

- Ngushëllimet e thella - Të gjithëve!

- E lehte qoftë Toka që të mbanë në gjil!

- Lamtumire, shokë e kumbare i dashur!

- I paharruar qoftë emri e kujtimi i tij!

Kolë Çardaku,

4 dhjetor 2023

REDAKSIA

Kryeredaktore: Klodjana Serraj

Luigj Shyti, Prele Milani, Lazer kodra, Lazer Stani, Roza Pjetri, Zef Nika, Vuksan Kola, Zef Gjeta, Ledia Dushi, Leke Sokoli, Edmond Tërthorja, Lulash Brigja, Vilson Peshkaj, Prele Shytani, Zef Bari, Gjon Fierza, Ndue Ziçi, Gasper Marku, Mark Gjeka.

**Mundësoi Botimin:
SOKOL NDREZAJ**

